

DOKUMENTE E MATERIALE

DHIMITËR S. SHUTERIQI

FSHATI SHQIPTAR I BULLGARISË, MANDRICA. STUDIM DHE TEKSTE

Më 1949, një nxënësi im, ahëre student në Universitetin e Plovdivit, më dërgoi tekstin e një kënge popullore shqipe, të mbledhur në fshatin shqiptar Mandricë të Bullgarisë, nga një mandricar vetë. Teksti ishte shkruar me alfabetin bullgar dhe unë e gjeta ahëre jo të përshtatshëm për botim. Prita rastin të shkoj vetë në Bullgari dhe të vizitoj të vetmin fshat ku ende flitet shqipja në atë vend. Kjo u bë në shtatorin e vitit 1959¹⁾.

Mandrica gjendet në këndin më juglindor të Bullgarisë, tamam në kufirin bullgaro-greko-turk. Është qendër lokaliteti në rrethin e Ivajlovgradit. Fshati është i veçuar në vise kodrinore dhe dushkaja. Është njëra 30 km nga Adrianopoli i Turqisë, të cilin mandricarët e quajnë Qytet, kurse çdo qyteti tjetër i thonë kasaba.

Në Turqinë e Evropës, në rrethet e Adrianopolit e të Kërklisesë, kanë qenë 8 koloni shqiptare në fillim të këtij shekulli: Mandrica, me 650 shtëpi, ishte më e madhja e pak e veçuar nga të tjerat. Pastaj vinin: Sulltanqoj, me 300 shtëpi, Ibriktepe (shqip, Qytezë), me 400, Alltëntash, me 150, Pazardere, me 150, Zallëf, me 450, Aballar (themeluar në vitet '80 të shekullit të kaluar, nga 60 shtëpi të Zallëfit), me 100 shtëpi, dhe Karaxhakli (themeluar në vitet '90 të atij shekulli, nga 16 shtëpi të Zallëfit), me 80 shtëpi²⁾. Një lajm i vitit 1926, na mëson se këto fshatra shqiptare ekzistonin akoma ahëre³⁾. Në Mandricë na thanë se matanë kufirit, në Turqi janë edhe këto fshatra shqiptare: Zallëfi, me afër 600 shtëpi, Alltëntashi, me afër 100 shtëpi, në lindje të lumit Marica; Ibriktepeja ose Qyteza, me afër 70 shtëpi, në perëndim të lumit. Noli vetë na mëson se, gjatë luftës ballkanike (1912), fshati i tij, Ibriktepe, u pushtua nga bullgarët, pastaj nga turqit e së fundi grekët, të cilët e prishën. Pas luftës greko-turke, më 1923, bashkë me grekët që u dbuan prej Turqie, u dbuan edhe ortodoksët shqiptarë të Ibriktepesë. Këta u vendosën në Greqi, në viset moçalore të Maqedonisë, ku shumica vdiqën nga sëmundjet. Ata që shpëtuan, përfunduan në mizerje në Selanik. Sot, gjithënjë sipas

1) Para nesh, në Mandricë ka shkruar shkrimtari Kolë Jakova, i cili botoi edhe një artikull të shkurtër, ku futi pak lëndë gjuhësore dhe një këngë shumë interesante të mbledhur prej tij: Një vizitë në fshatin Mandrica, te rev. «Nëndori» 1957, nr. 12. Ribotojmë në «Shtojcë», nr. 2, këngën e mbledhur prej tij. Po aty, nr. 1, botojmë këngën që na dërgoi nxënësi ynë më 1949 dhe që është një variante e «Këngës» 2. të mbledhur prej nesh.

2) H.A.Frashëri, Letër nga Adrianopoja, te «Kalendari kombiar» 1901, fq. 70-71.

3) Popullsia shqiptare më 1924 jashtë Shqipërisë, te «Kalendari kombiar» 1926, fq. 36.

Nolit, Ibriktepeja banohet prej turqish të ardhur nga Maqedonia e Thraka¹⁾, kurse në Mandricë na thanë se atje flasin akoma shqip.

Mandrica është përmbledhur pranë lumenjve të vegjël Akçehisar dhe Këzëll Delidere. Ka rreth 200 shtëpi, pra është shumë më e vogël nga ç'ishte në fillim të këtij shekulli. Të gjithë flasin shqip, edhe bullgarët që banojnë aty. Takuam një ushtarak bullgar, i cili kishte diçka më shumë se një mot në Mandricë dhe që merrte vesh gjuhën e fshatit, kurse fëmijët e tij e flitnin shqipen si mandricarë të vërtetë²⁾. Gjithë shqiptarët, me ndonjë përjashtim të rrallë, flasin edhe bullgarisht.

Mandrica më 1959 kishte një shkollë shtatëvjeçare, një çerdhe fëmijësh, klub, pak dyqane, dy kisha. Dy vjet më parë, fshati ishte bërë kooperativë. Kjo ngjau vonë, sepse vonë u erdhì radha për kooperim viseve të tilla të veçuara pyjore. Që vitin e parë, Mandrica u rendit ndër kooperativat me të ardhura mesatare në Bullgari, gjë që tregon se shqiptarët e atyshëm janë punëtorë të zot. Kultura kryesore është duhani, po mbjellin pak nga të gjitha. Merren shumë edhe me rritjen e mëndafshit. Ngado që të shkosh në fshat, do të shohësh mana, me fletët e të cilëve ushqejnë krymbat e mëndafshit, «kukulet». Ndër pemët që atje rriten më shumë, janë arrat. Kodrat pranë i mbulojnë vreshtat. Mandrica bën verë e raki të mirë.

Shtëpitë janë zakonisht dykatshe, ndërtuar me qerpiç, sepse guri është i pakë. Shumica janë të lyera me gëlqere nga jashtë dhe fshati, prej së largu, duket si një tubë lulëshqerash midis gjelbërimit. Elektriку po bën vjet që ka hyrë në Mandricë. Brenda shtëpive të bie në sy pastërtia dhe mobilimi i mirë. Mandricarët janë nikoqirë dhe mikpritës. Më parë, ata kanë njohur varfërinë e zezë. Shumë janë shpërngulur. Disa, në kohën e Zogut dhe të pushtimit fashist, provuan të vendosen edhe në Shqipëri, po këtu s'gjetën përkrahje dhe u kthyen prapë. Njohëm dy-tri familje që kishin jetuar pak kohë në Tiranë.

Një gjë binte në sy menjëherë në Mandricë: patriotizmi i thellë shqiptar. Ishte për t'u çuditur. Sikur të kish punuar atje me vjet ndonjë nga rilindësit tanë. Dashuria për gjuhën dhe zakonet shqiptare ishte e madhe. Mburra për historinë e lashtë dhe të re të Shqipërisë, gjithashtu. Atje na folën për stërgjyshët pelazgë, për Skënderbeun, për luftrat e popullit tonë kundër Turqisë dhe pushtuesvet të ndryshëm, për orvatjet e kota të turqëve dhe grekëve që të na mohojnë dhe të na këmbëjnë kombësinë³⁾. Na u mburrën, për Shqipërinë socialiste, na pyetën shumë për jetën e sotme në Shqipëri, për Partinë tonë etj. Dëshira e tyre e madhe ishte që të mësojnë të lexojnë shqip, të kenë libra dhe gazeta shqip, të takojnë bashkatdhetarë nga Shqipëria. Radio Tiranën e dëgjonin me rregull, ndonse gjuhën tonë pak e

1) Fiftieth Anniversary of the Albanian Orthodox Church in America, 1908-1958 compiled by Metropolitan Fan S. Noli, Boston 1960.

2) Një fenomen i njëjtë vihet re edhe në fshatin shqiptar të Karakurit, në Besarabi, ku edhe banorët prej kombësie tjetër, si gagauzët, bullgarët, ukrainasit, flasin edhe shqip (N. V. Kotova, Materiali po albanskoj dialektologii, në Uçenie zapiski Instituta slavjanovedenija, Moskë 1956. fq. 254-287).

3) Nuk qe e mundur që, në atë pak kohë, 3 dit, të hetojmë mbi arësytet e zhvillimit të ideo patriotike shqiptare në këtë koloni të largët e atë veçuar. Le të vemë re se Noli, po aty, na tregon se si në fëmëni të vet lexonte me kënaqësi të madhe librat e Kristoforidhit dhe me entuziazëm historinë e Skënderbeut greqisht. Ky fenomen ngjan të mos ketë cenë kurrë i rrallë të shqiptarët e atyre viseve.

merrnin vesh. U pëlqenin fort këngët tona dhe disa prej tyre i kishin mësuar. Kudo që vajtëm, na pritën me mallëngjim e po kështu na për-collën. Plaka 70 vjeçe, Stanoja e Gjenços, na tha: «Kur shihemi me juve, më vjen gëzim: vëllazëratë më dukeni që jeni». Dhe Maria Apostolli na porositi: «Shumë faltura (të fala) bëni nga shqiptarëtë të njikohshim (të dikurshëm) nga Mandrica». Porosi të tilla na dhanë edhe të tjerë. Nasho Dakoja na dha një degë mani plot mëshika mëndafshi, tharë në furrë, që ta sjellim për kujtim në Shqipëri. Ky ishte një nga nderet më të prekëshme që mund të bënte një mandricar. Në mesin e kishës së Shën Mitrit, në fshat, gjendet një pllakë guri, mbi të cilën ishte skalitur shqiponja me dy krerë. Ndofta kjo ishte shqiponja e Bizantit, e skalitur prej kishës greke. Po mandricarët e njihnin për simbol të atdheut të tyre të lashtë dhe na e treguan me krenari të madhe, si she-një të qëndresës së tyre përmes viteve. Edhe tokat e brezave të gra-ve, me shqiponjë të tillë janë.

* * *

Sipas gojëdhanës (v. tekstet që botojmë), Mandrica u themelua nga dy ose tre vëllezër shqiptarë, ose nga një numur i vogël familjesh, barij e «dostafçikë», d.m.th. furnizues në mish të ushtrisë turke, tregëtarë bagëtitsh. Sulltani ua paske falur atë vend, të cilin e zgjodhën vetë. Aty s'kishte pasur fshat më parë. Emrat e theme-luesve të Mandricës, rrallëkush i përmend akoma. Shimion Gulam-xhiu na tha se quheshin Joan, Gjorgji dhe Shtifan. Mite Dailovi na tha se quheshin Risto, «tri Ristora». Sot, fis me këtë llagap nuk ka në Mandricë. Njëri të pakën nga të tre vëllezrit ishte beqar dhe mori grua në fshatin bullgar fqinjë, në Gjushqinar. Kështu nisi krush-qia shqiptar-bullgar e anasjelltas, krushqi që vazhdon gjithmonë mi-dis Mandricës dhe fshatrave bullgare përreth.

Zakonisht, në Mandricë të thonë se janë me origjinë nga Korça ose nga Vithkuqi i Korçës. Dine Ollovadovit, i jati i ka thënë se fshati u themelua para se turqit të marrin Stambollin (1453). Te kjo kohë aludon edhe kënga e mbledhur nga sh. K. Jakova në Mandricë. Këtë gojëdhenë na jep edhe Noli për fshatrat shqiptare të rretheve të Adrianopolit e Kërklisesë. Noli vë besim te ajo gojëdhenë e mendon se këto fshatra u themeluan nga mercenarë shqiptarë të kohës së perandorëve të Bizantit. Sipas një tjetër gojëdhenë, që dëgjuam në Mandricë, fshati u themelua në kohë të Ali pashës (së Tepelenës), apo në kohën kur luftonte Turqia me Rusinë («dë Turqisë kohë, kur u rahnë me Rusnë», na tha Risto Haxhievi). Mite Fënuqovi, 86 vjeç, me sa dukej plaku më i vjetër në fshat, na tha se Papa Todori i mbante mend ata tre çobanët që themeluan Mandricën. Papa To-dori ka lënë kujtim pak a shumë të qartë në Mandricë, dhe ka jetuar rreth kohës kur u ndërtua kisha e parë e fshatit, d.m.th. në pjesën e parë të shek. XIX. Sipas Stanos së Gjenços, fshati e mori emrin nga mandra që krijuan aty çobanët shqiptarë. Pra emri i fshatit duket të vërtetojë edhe mjeshtërinë e parë të themeluesve të tij.

Mandrica u rrit shpejt. Një gjysh i Shimion Gulamxhievit, sipas dëshmisë së Shimionit, vajti e mori në Stamboll fermanin për ndërtimin e kishës së Shën Nedelës (1816), që është pak anas fshatit,

mbi një kodër, ku gjenden edhe varret. Më 1835 u ndërtua një kishë e dytë, ajo e Shën Mitrit, në mes të fshatit. Pleqtë e sotëm mbajnë mend që fshati të ketë arritur mbi 450 shtëpi, kurse ne pamë se më 1900 ai kishte rreth 650. Në kohën e sundimit turk, aty kishte shkollë greke, si dhe në fshatrat e tjera shqiptare të Thrakës¹). Më 1912, kur fshati u bashkua me Bullgarinë, shumë mandricarë u shpërngulën e themeluan pranë Selanikut një tjetër fshat. Të dy palët ruajnë edhe sot marrëdhënie me letra. Pas bashkimit me Bullgarinë, Mandrica ka pasur shkollë bullgare. Sot, veç një pakice pleqsh me arësim grek ose analfabetë, të tjerët kanë arësim bullgar gjysëm të mesmë ose të mesmë.

Kolonizimi shqiptar në Bullgari sipas Jireçekut, mund të ketë lidhje me pushtimin e Shqipërisë dhe të Moresë nga Turqia, pra të ketë filluar që nga shek. XV²). Pamë se gojëdhëna atë e bën edhe më të lashtë. Emigrimet kanë pasur si arsye jo vetëm luftrat, po edhe ngushticën ekonomike, shtypjen feudale etj, dhe kanë qenë të shumta. Kështu, më 1555, shohim shqiptarë që venë në Rumeli për punë stinore³). Më 1595, «në Bullgari gjinden shumë fshatra të banuara prej shqiptarësh nga të cilët mund të bëheshin 7 mijë, trima të mirë dhe të armatosur», thotë një dëshmi e kohës. Vetëm nga shqiptarët e Tërnovos mund të dilnin 1500 pushkë⁴). Është pra fjala për emigrime dhe koloni pak a shumë të mëdha. Jireçeku na mëson se, në shek. XVII, fshati Kopolovci banohej prej shqiptarësh katolikë, kurse dihet që Arbanasi i Tërnovos qe ortodoks. Ndërsa banorët e Arbanasit kanë emigruar nga viset e Çamerisë, ata të Kopolovcit ka mundësi të kenë qenë prej Shqipërisë së mesme ose të veriut. Gjithë sipas Jireçekut, shqiptarët e Provadisë, pranë Varnës, që banonin në Dobrino, Eski Arnautllar, Dereqoj, Djevna, Karahysen, Tyrk Arnautllar, sipas gojëdhënës, kishin qenë bujq dhe tregëtarë bagëtitsh, d.m.th. «dostafçikë», siç i bën gojëdhëna edhe shqiptarët e Mandricës. Emra vendesh të quajtur Arnaut ka pasur shumë në Thrakë. Në Stanimakë gjendeshin dy Alvanitohorie, njëri i bullgarizuar dhe tjetri i greqizuar, po që kishin qenë me siguri

1) Noli, **po aty**, dëshmon se shkolla greke e Ibriktepesë kishte 6 klasë. Në rev. «Nazione albanese», 15.III.1901, fq. 9, mësojmë se shkollat greke të këtyre kolonive shqiptare u çelën n'ja dhjetë vjet më parë, d.m.th. rreth vitit 1890. V. edhe H.A. Frashëri, **po ai artikull**.

2) C. Jirecek, **Das fürstenthum Bulgarien**, Vienë, 1891, fq. 124-125. V. Marinov, **Minalloto na s. Devnja, Provadijsko, s'ogled na «Arnautite» v severoiztočna Bëllgarija**, në *Ezikovedensko-etnografiski izsledvanija v pamet akad. Stojan Romanski, Sofje*, 1960, fq. 591, shënon se Jireçeku ishte marrë që më 1884 me «arnautët» e Bracigorës, të cilët paskëshin ardhur nga fshatrat e Kosturit, në punimin e tij: **Pëtni belleski za Sredna gora i za rodopishte pllanini**, në *Periodičesko spisanie*, vëll. XI, fq. 4-5. Me këtë çështje ishin marrë para tij dy bullgarë, Athanas Mishev dhe Aleksandër Teodorov Ballan, më 1881 dhe 1882; ata janë të parët që prekën problemin e emigrimeve shqiptare në Bullgari. Shumë qenë ata që u morën më pas në Bullgari dhe gjetiu me këtë çështje. Midis tyre duhet përmendur D. Jaronov, **Preselničesko dvozhenie na bëllgari na Makedonia i Allbania këm ustocnite bëllgarshizemi prez XV do XIX vek**, në *Makedonski pregled* 1932, fq. 63-118. Ky u përpoq të përcaktojë rrugët e emigrimit. Teza e tij, se «arnautët» e Bullgarisë janë, veç ndonjë rasti, bullgarë që më parë banonin në viset e Shqipërisë, kërkon ta minimizojë emigrimin shqiptar në Bullgari. Atë tezë ka edhe Marinovi, që përmendëm, po me ndonjë farë rezerve.

3) **Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë**, Tiranë, 1962, vëll. III, fq. 157-158.

4) Jireçek, **po aty**, sp Makushev, **Monumenti hist. Slav. merid. II**, fq 246 252

shqiptarë ose të paktën vllëh nga Shqipëria, na mëson Jireçeku. Për shqiptarët e Djevnës, që përmendëm më lart, dihet se ata, në kohën e luftës ruso-turke të viteve 1828-1829, kur fshati u prish, emigruan në Besarabi dhe, prej këtu, një pjesë shkuan në Ukrainë pas vitit 1856, gjithmonë po për arsye të luftës midis Rusisë dhe Turqisë. Në Besarabi, ata u vendosën në fshatin Karakurt dhe në fshatra të tjera pranë, ku në fillim të shek. XIX dihet se ka pasur edhe shqiptarë të tjerë¹). Në Ukrainë, ata krijuan tri fshatra në rrethin e Melitopolit, Gramovka, Gjeorgjevka dhe Djevnjeskoje. Këto fakte të fundit japin një ide të lëvizjeve të shqiptarëve në Ballkanin lindor e gjer në Ukrainë, sipas fatkeqësive që i pllakosnin. Lëvizje të tilla nuk duhet të kenë qenë të rralla. Ato japin një ide edhe të qëndresës së shqiptarëve midis të huajsh, me që edhe sot e kësaj dite, në Besarabi dhe në Ukrainë, shqipja ruhet. Nga sa dimë gjer më sot për gjuhën e kolonisë së Djevnës, që u zhduk, dhe të kolonive të Besarabisë e të Ukrainës, ajo është e dialektit toskë. E tillë është edhe gjuha e Mandricës, Ibriktepesë dhe fshatrave të tjera të rretheve të Adrianopolit e Kërklisesë. Pra, me sa jemi të informuar gjer më tani, në Ballkanin lindor emigrimet ishin nga Shqipëria e Jugut.

Edhe të tjera burime flasin për emigrime në Bullgari nga viset tona jugore. Nga një dokument i vitit 1819, mësojmë se fshati i Peshterit, në Rodopet, banohej prej vllësh të ardhur nga Voskopoja²). Është fjala, sigurisht, për një emigrim bërë pas prishjes së Voskopojes në kohën e luftës ruso-turke të viteve 1766-1769. Aravantinoi na mëson se, aty nga mezi i shek. XVIII, duke mos duruar dot hajdutët e dhunën feudale, shumë banorë të krahinës së Korentës së Janinës, kryesisht vllëh, u vendosën në afërsitë e Stambollit, ku themeluan fshatin Arnautqoj³). Që fshati të ketë marrë këtë emër, besohet se nga rrethet e Janinës nuk u shpërngulën ahëre vetëm vllëh, po edhe shqiptarë. Në Enciklopedinë e tij, S. Frashëri shënon disa fshatra të Rumelisë dhe të Stambollit me emrin Arnautqoj. Sipas Aravantinoit, edhe banorët e mëparshëm të Lazaratit të Gjirokastrës braktisën fshatin dhe u vendosën në Thrakë, sepse nuk duruan më dot dhunën e Kapllan pashë Delvinës. Ata e kishin pasur zakon të emigrojnë periodikisht në Stamboll, për punë. Kapllan pasha e kolonizoi Lazaratin me labë⁴). Ai u vra më 1767. Nga tmeri që panë prej Ali pashë Tepelenës më 1774, shumica e banorëve të Hormovës ikën dhe u vendosën në Bullgari dhe Azi të vogël, kurse disa qëndruan pranë Butrintit⁵). Gojëdhëna na mëson se edhe banorët e Gostivishtit (Kolonjë), që më parë mban-te emrin Peras, braktisën fshatin dhe u vendosën në Thrakë, sepse nuk e duruan dot më dhunën e feudalit të tyre⁶). Edhe sot duken rrënimet e Perasit. Ka shumë mundësi që edhe ky emigrim të jetë i shek. XVIII.

Le të shohim tani çështjen e themelimit të Mandricës.

1) S. Islami, *Material gjuhësor nga kolonitë shqiptare të Ukrainës*, në Buletinin e Shkencave Shoq., Tiranë, 1955, nr. 2, fq. 163-180.

2) Jirecek, *po aty*, fq. 118.

3) K. Aravantino, *Hronografia tis Iptru*, Athinë, 1856, vëll. I, fq. 249-250.

4) *Po aty*, fq. 246, sh. 2.

5) *Po aty*, fq. 253.

6) O. Haxhihasani, *Ekspedita folklorike e Kolonjës*, në Buletinin e Shkencave Shoq. 1956, nr. 2, fq. 190.

Ne vizituam kishën e parë të fshatit, atë të Shën Nedelës, të themeluar më 1816, siç e tregon mbishkrimi që gjendet mbi portën e saj jugore. Ktitorë ishin Papa Dhimitri, Kostanti Moskoja, Gjorgji Theodhori e Hristo Mjeshtri, sipas këtij mbishkrimi greqisht: **KTITO PAC 1816/ ΠΑΠΑ ΔΗΜΗΤΡΗ ΚΟΣ/ΤΑΝΤΗΝ ΜΟΣΚΟΓΙΟ/ΡΤΙ ΘΟΔΟΡΗ ΓΙΟΡ/ΤΙ ΧΡΙΣΤΟ ΔΙ Ο ΜΑΚΤΟΠΙ**, Ikonostasi u punua më 1817-1818 nga zografët vëllezër Konstantini dhe Gjorgji, si dhe ortaku i tyre Joani. Ka dhe ndonjë ikonë më të re, të vitit 1858. Kisha është e vogël. Asaj i ka qenë shtuar një kthinë nga ana perëndimore. Në murin perëndimor të kësaj shtojce, te porta, lart nga e majta, është kthitur një gur varri që mban datën 1908. Pjesa e re e Kishës duhet të jetë ndër-tuar pra në këtë datë ose më vonë. Në murin jugor të kësaj pjese, gati rrafsh me dheun, është kthitur një tjetër gur varri, i cili flet për një Papa Kristo, vdekur më 1778: + **ΜΑΚΑΡΙΟ [Τ] ΙΣ ΠΑΠΑ ΧΡΙ[ΣΤΟ] ΕΤΟC 1778**. Është dëshmia më e vjetër që mundëm të zbulojmë në Mandricë. Guri, me qëllim duket të jetë vënë në atë vend, që të mos humbë dhe të dëshmojë për lashtësinë e fshatit. Kërkuam me durim nëpër varret e vjetra rreth kishës dhe zbuluam një tjetër gur, që mban datën 1870. Varret vinë e shpeshohen pas viteve 1815-1820, kur akoma janë të paka.

Po të marrim parasysh këto fakte e gojëdhënën e Mandricës, që thotë, se fshati u themelua në kohë të Ali pashë Tepelenës¹⁾, mund të pranojmë se më 1816, kur u themelua kisha, fshati nuk duhet të ketë qenë fare i vogël. Atë kohë, në Mandricë gjejmë 3 esnafe të bojaxhinjve, kujunxhinjve (argjendarë) dhe mutafcinjve (lëkurëpunues), që falën ikonën e fronit të dhespotit më 1817. Që Mandrica ahëre nuk ka qenë fare e vogël, kjo kuptohet edhe nga fakti se, as njëzet vjet pas kishës së parë, mandricarët ngritën një të dytë, kësaj here vërtet të madhe e në mes të fshatit, kishën e Shën Mitrit (1835). Që të gjejmë një prift në Mandricë dhe varre ç'prej viteve 1778-1780, kjo mund të thotë se një kishë, sado provizore, ta zemë e drunjte, atje ka ekzistuar për-para kishës së vitit 1816. Le të vëmë re se emri i priftit të parë të njohur nga dokumentet, ai i vitit 1778, është papa Kristo. Ky emër i përgjigjet gojëdhënës, sipas së cilës Mandrica u themelua nga «tri Ristora», prej të cilëve njëri ishte prift, dhe u themelua «dë Turqisë kohë, kur u rahnë me Rusnë». Kuptohet se është fjala për luftën e viteve 1766-1769 dhe për një emigrim nga Shqipëria bërë gjatë ose fill pas kësaj lufte. Gojëdhëna na mëson se, në vendin ku u themelua Mandrica, nuk pat ndonjë qendër më të vjetër banimi. Kjo shpjegohet me pozicionin ende fort të veçuar të fshatit midis pyjeve. Thuhet se fshati u themelua nga vithkuqarë ose shqiptarë të Korçës. Më lart pamë se nga rrethet e Korçës (Voskopoja) dhe të Kolonjës (Perasi), në shek. XVIII, në Thrakë kanë emigruar më se një herë njerëz. Është koha kur prishet Voskopoja, Vithkuqi, Nikolica dhe Shipska, që nga viti 1769. Ndër llagapet e sotme të mandricarëve, gjejmë disa që i hasim edhe në krahinat e Korçës, si Dakov (Dako), Germanov (Gërmenj), Gramenov, Moskov. Llagapi Dangallov të kujton emrin e krahinës së Dangëllisë, kurse llagapi Toska, fshatrat Toshkëz të Lushnjës dhe Tepelenës ose banorin e krahinës së Toskërisë; llagapi gjendet

1) Këtë lexoi edhe Mite Dailovi më 1917 në Selanik, në një libër greqisht që fliste për Mandricën.

edhe tek arbëreshët e Greqisë që nga shek. XV. Sidoqoftë, në këto emra duhet të mbështetemi me shumë rezervë. Disa prej tyre, si Grameno apo Mosko, i hasim edhe në viset e Maqedonisë apo të Janinës e gjetiu¹).

Gjithçka duket të tregojë pra, se Mandrica u themelua pas luftës ruso-turke të viteve 1766-1769, nga shqiptarë të rretheve të Korçës, posaçërisht të Vithkuqit. Po ky pohim nuk duhet marrë për i sigurtë sa kohë që s'kemi edhe të dhëna të tjera dokumentare, që të plotësojnë në mënyrë vërtet të kënaqëshme legjendën dhe dokumentet që kemi sot.

Është me interes të vështrohet në këtë drejtim gjuha e Mandricës e po kështu edhe folklori i saj. Takimet që ka shqipja e atyshme me shqipen e kolonive të Besarabisë dhe Ukrainës (v. Shënimet mbi gjuhën e Mandricës), mund të jenë shenja marrëdhëniesh të herëshme midis të dy palëve, sikundër janë ndonjëherë edhe shenja të një ndikimi të përbashkët bullgar. Tipike për kontaktet e tyre ose për origjinën ndofta të përbashkët, është fjala *zallahinj* (flas). Po të dhëna të tilla nuk na japin gjë për të caktuar pak a shumë kohën e emigrimit të këtyre kolonive nga Shqipëria.

Arkaizmat e shumta që hasim në gjuhën e Mandricës janë të llojeve dhe kohëve më të ndryshme. Bie në sy diftongu i lashtë *uo*, përkrah trajtës *ua*, që në të folmen e këtij fshati është më e zakonshme. Po të bazoheshim te ky fenomen, duhej të thoshim se mandricarët janë shpërngulur nga Shqipëria në një kohë kur ishte nga fundi kapërximi prej *uo* në *ua*. Dimë se në fillim të shek. XVII, siç na dëshmohet te Budi (1618-1621), diftongu *uo* është shumë i gjallë, të pakën në gegërishten e mesme. Pra afrohemi nga shek. XVIII ose vëmë në këtë shekull. Po dihet se trajta e lashtë *uo* haset edhe sot më ndonjë vend të Shqipërisë, fjala vjen në Dibër, dhe mund të ketë ekzistuar pas shek. XVII edhe në krahina të tjera të vendit, veçanërisht në ato të Korçës, prej ku duket të jenë mandricarët. Po përkrah trajtave *uo* dhe *ua*, në të folmen e Mandricës gjejmë edhe *ue* apo *u*, si dhe *uve* apo *uvë*, sado rrallë. Këto vështrohen si fenomene të gegërishtes. Mos kemi ahëre edhe një ndikim gegë në të folmen e atij fshati? Kështu na del më i ndërlikuar problemi i origjinës së Mandricës.

Nga emigrimet e ndryshme që pamë se janë bërë prej Shqipërie në viset e Thracës e përgjithësisht të Bullgarisë, pse të mos ketë pasur edhe elemente nga Shqipëria e mesme, në mos dhe e veriut? Shenja elementesh nga Shqipëria e mesme kanë qenë vënë re më ndonjë stu-

1) Po japim, në këtë shënim, toponimet dhe llagapet e Mandricës. **Toponime:** Ada, Akçehisar (lumë), Çerqedekli derë, Çitakat prrua, Çukallos prrua, Çukatë, Gramençes bunar, Groshkuvica (ara), Gurun (pyll), Gjolet, Hallashllisë hushë (fushë, ara), Haxhi bunar, Kamiles prrua, Kavak derë, Këllut pazllak (mal), Këzell deli derë, Kokar bunar, Lartmi hushë (ara), Linos prrua, Maçes prrua, Mazi pazllak (pëllajë), Motuk (vend me bahçera), Mugjilla (mal), Peperit kodër, Petroll bunar (burim), Qirjalejson (manastir), Semer burun (mal), Sivri tepe (mal), Sheshet, Tilqixhik (ara dhe vreshta), Toft' uë (nyll dhe burim), Veranet (ara dhe vreshta). **Llagape:** Aleksandrov, Apostolov, Babrikov, Bazhdërvanov, Bejçev, Bojaxhiev, Çafov, Çelingerov, Çëfudov, Çukanov, Daillo, Dajçev, Dakov, Dangallo, Derebeev, Fënukov, Gajdexhiev, Gërmanov, Gramenov, Gulamxhiev, Gjënçev, Haxhijev, Jallamov, Kadënkov, Kallajxhiev, Karafillov, Karagjozov, Karakaçanov, Karaolev, Kirev, Kurxhiev, Llazov, Majkov, Mavinov, Millushhev, Moskov, Ollovadov, Paskales, Peev, Popov, Siderov, Sillkov, Tomkov, Toska, Tytynxhiev, Vezirov.

dim të mëparshëm mbi gjuhën e kolonive të Ukrainës¹). Po le të shënojmë edhe një herë faktin se në Mandricë ndjenja patriotike shqiptare është shumë e zhvilluar, gjë që na duket e vështirë të shpjegohet pa një kontakt me lëvizjen tonë të Rilindjes, që pat një ndër qendrat e saj edhe Stambollin. Kristoforidhi që lexohej në Ibriktepe, mund që është lexuar edhe në Mandricë. Të mos harrojmë edhe faktin fare të ri, të banimit të disa mandricarëve në Tiranë gjatë kohës së Zogut dhe të pushtimit fashist italian.

Fenomen i veçantë për të folmen shqipe të Mandricës, është ndikimi i thellë bullgar në fonetikë, në trajtat morfologjike e në sintaksë. Ky ndikim është i madh edhe në fjalor dhe sa vjen e shtohet, ndërsa ndikimi i mëparshëm turk, që është gjithashtu i madh, apo ndikimi grek, që është i kufizuar, tani kanë filluar të humbin teren. Si shpjegohet që, brenda më pak se dy shekujsh, — nëqoftëse pranojmë tezën e një origjine nga shek. XVIII të Mandricës, — gjuha e fshatit pësoi një ndikim aq të thellë bullgar, kurse gati 150 vjet fshati ishte nën Turqinë dhe as 50 vjet nën Bullgarinë? Mandrica gjendet në një rreth thuase krejt bullgar. Mandricarët janë martuar vazhdimisht me vajza nga fshatrat bullgare fqinjë. Sipas gojëdhënës, kjo ka ngjarë që me themelimin e fshatit. Martesa me grekë nuk mbahen mend të jenë bërë, kurse me turqit krushqia ishte e prerë, për shkak të fesë. Gratë bullgare të martuara në Mandricë, këtu mësonin e flisnin shqip, sikundër dhe burrat e tyre mësonin e flisnin bullgarisht. Ne njohëm dytri gra bullgare që ishin martuar në Mandricë dhe që flisnin shqip. Shqipen, domosdo, bullgarët e kanë folur dhe e flasin nën ndikimin e bullgarishtes. Ato flasin shqip, po edhe mendojnë bullgarçe. Kështu shpjegohet ndikimi i shpejtë e i thellë i bullgarishtes mbi të folmen e Mandricës. Ky ndikim ka vajtur duke u theksuar, veçanërisht që nga viti 1912, kur u vendos administrata dhe shkolla bullgare, kur duhet të jetë vendosur edhe kisha bullgare, megjithëse mbishkrimet greke të kishës së Shën Mitrit, bullgarisht u bënë vetëm më 1925, me sa na thanë, kurse mbishkrimet greke të kishës së Shën Nedelës nuk u preken. Le të vemë re se, pranë trajtave të ndikuara nga bullgarishtja, si fjala vjen ze, sa, gjejmë edhe trajtat e pandikuara, dhe, tha. Kjo tregon se ndikimi bullgar, sado i thellë, nuk ka mundur të bëhet i plotë edhe në raste të tilla, se në Mandricë, gjer më sot, shqipja nga më se një anë i ka shpëtuar ndikimit të huaj.

Le të themi së fundi disa fjalë për lëndën gjuhësore dhe folklorin që mbledhën në Mandricë²).

Ne u përpoqëm, ato tri dit që kaluam në atë fshat, të mbledhim sa më shumë lëndë gjuhësore dhe folklor. Mbledhëm disa qindra fjalë të sferave më të ndryshme, fraza e frazeologji, hetuam zgjedhimin e një numur foljesh. Këto i mbledhëm qoftë duke përdorur një kështionar të thjeshtë që kishim përgatitur më parë, qoftë duke mbajtur shënime gjatë bisedave të lira. Mbledhëm llagapet e banorëve, toponiminë e fshatit, 17 këngë (disa në dy e më shumë variante), 4 përralla, 3 gjëza. I dhamë rëndësi të veçantë mbledhjes së gojëdhënës mbi themelimin e Mandricës dhe na u bënë 9 variante të saj, nga 7 persona. Sekretari i

1) Islami, po aty.

2) Lëndë etnografike nuk patëm kohë të mbledhim. Fotografuam kostumet tradicionale të grave (të burrave kanë humbur), fotografuam ose vizatuam edhe disa gurë varresh karakteristike.

partisë në fshat na tregoi historinë e kooperativës. Kishim me vete një manjetofon, që na shërbeu për të saktësuar mjaft gjëra. Shoku Thoma Kacori, që na shoqëronte ato ditë dhe të cilit i falemi nderit me këtë rast, na ndihmoi shumë duke bërë shpesh pyetje bullgarisht, duke pyetur fshatarët për fjalët e shprehjet e panjohura prej nesh, si dhe për çështje të ndryshme që na interesonin. Familiarizimi ynë me të folmen e Mandricës që i shpejtë: që në mbarim të ditës së parë nisëm të kuptojmë pa shumë vështirësi.

Folklorin e mblodhëm si e solli hera, kudo dhe kurdo. Nuk arritëm të mbledhim këngët rituale, të cilat do të mund të na jepnin një ide mbi gjendjen e folklorit të vjetër shqiptar sot në Mandricë. Këngët që mblodhëm, zor të thomi se kanë të bëjnë me floklorin e njohur të Shqipërisë dhe të kolonive arbëreshe. Ato duket të jenë krijuar në vend, nën ndikimin e këngëve bullgare. Ndonjë prej tyre, mësuam se thuhet edhe bullgarisht, si kuptohet dhe prej brendisë: Kënga 14, «Tudorqe, bukor Tudorqe», ku flitet për hajdutin e famshëm bullgar, Karaxhanë, i cili luftoi kundër turqëve në shek. XIX. Sidoqoftë, ndonjë këngë na duket se ka elemente mjaft të vjetra. Kënga 11, «Engjelinko, toglë çupë», bën fjalë për detin. Ky fakt mund të lejojë supozimin se në Mandricë janë vendosur edhe bregdetas. Kënga 10, «Bilbili këndon dhe shkozë», fillon me një varg tipik të folklorit shqiptar. Po hyrjet e pothuaj gjithë këngëve, me vargun e tyre të parë, me fjalën «mëmo» ose «mëmo-lo», janë tipike të këngëve bullgare. Emrat e personave për të cilat flasin këngët, janë gjithashtu gati të gjitha bullgare.

Këngët, të gjitha, janë fare pak të rimuara, karakteristike kjo e folklorit të vjetër shqiptar, po jo e atij të shek. XVIII, me sa e njohim sot. Mos kjo mungesë e rimës ka të bëjë me ndikimin nga folklori bullgar? Mundet. Zor të nxjerrësh prej këngëve se cili është vargu ose cilat janë vargjet bazë të tyre. Shumica janë ndërtuar në vargje 6-9 rrokjesh. Po shumicën ne e mblodhëm me vesh, më shumë të recituar se të kënduar, në prak të derës ose në oborr, në arë ose në klub, ku nuk qe e mundur të përdorim manjetofonin. Kënga 2a, «Ne jerë, mëmo, ne djelë», që na u këndua nga Sulltana Tabakçieva, është në vargje të përzjera prej 6-9 rrokjesh. Kënga 3c, «Tatja vate dhe kurbet», që regjistruam në manjetofon dhe që këndoi Ana Mullushi, ka në bazë vargun tetërokës, me dy theksa kryesore, 3.7. Po skema e këtij vargu, po të mbështetemi te melodija që e përcjell, është kjo: vv \angle /vvvv \angle . Pra, një nëntërokës oksiton. I këtitillë është dhe vargu i këngës 5b, «Dimço-lo, biro-lo, Dimço-lo», që na këndoi Dili Cankov. Ky duket vargu bazë i shumicës së këngëve që mblodhëm. I tillë është vargu i Këngës 12b, «Millke-le, mari bukorë», që na këndoi Elena Majkova dhe që regjistruam në manjetofon. Edhe ninulla që këndoi për ne Majdalino Toska, Kënga 17, «Se nuku ndrohe, Zllate-le», kishte si ritëm të melodisë: vv \angle /vv \angle /v \angle , pra një varg të tipit nëntërokës. Meloditë që dëgjuam na u dukën tipike bullgare.

Përsa u takon përrallave, le të vemë re se vetë kjo fjalë në Mandricë nuk njihet, po përdoret «masallë». Midis 4 përrallave që mblodhëm, është edhe ajo e Maro Përhiturës, «Maraflos masalla», ku ruhet pra emri Marë për protagonistin.

Le të shënojmë së fundi se, midis personave që na i dhanë këngët e përrallat, është Maria Llambria Popova, këngëtarja më e çmuar e

fshatit. E çmuar si këngëtare ishte edhe Sulltana Tabakçieva. Ana Mullushi dallohej si njohëse përrallash.

I vetmi përfundim që mund të nxjerrim nga sa thamë, është se ne njohëm pak ase tepër pak folklor që të mund ta kishte origjinën prej Shqipërie. Ndikimi i madh i folklorit bullgar mbi folklorin e Mandricës, kur është fjala për këngët, duket lehtë. Po fakti që ne nuk mblodhëm këngët rituale, na bën të mos japim dot një mendim më të plotë mbi këtë çështje.

TEKSTE TË SË FOLMES SË MANDRICËS

KËNGË

1.

TË SHOHËSH, MËMO, TË USHTROSH..

- «Të shohësh, mëmo, të ushtrosh
ni çime bukor çupë:
surati barzë pës akul,
sjutë e zeza pës kershî,
5 trupi hi hollë posi fidan,
gjoksi plot verda flori.
— Mere, tinë Stojan, atë çupë.
— Kush t'e mar, mëmo, atë çupë?
Nuk më mer, mëmo, mua ai çupë.
10 — Gënee, Stojan, gënee;
mere tin' atë çupë.»
Stojani e gënejti
çupën, pa e muar.
Recitoi Sulltana Tabakçieva.

2.

NE JERË, MËMO, NE DJELË...

- 15 Mëmo-lo, mëmo bukorë,
ne jerë, mëmo, ne djelë.
Pa m'u sëmur çupa,
pa sëritnë heqimet,
heqimet me xharahet.
Pa nisë, mëmo, të xallahijnë
20 heqimet me xharahet:
«Kuju çupë nuk isht sëmure,
Po ishtë përë vjezorë.»
«Mëmo-lo, mëmo bukorë,
të sëresesh timenë trim Vasillaqnë,

- 25 të më bëjë, mëmo, ni argjentë sindjuk,
pa t'më lishoj, mëmo, dë Merixhì,
pa t'më zejnë kaikçintë,
pa t'më shpëtojnë nga heqimetë.»
Pa ashtu bënë.

Anë.

Rec. dhe këndoi S. Tabakçieva.

b.

- 30 Tashti djumbëzjetë vjeç,
ne jerë kam parë, ne djelë.
Pa u sëmur-si çupa,
pa sëritmë heqimetë,
heqimetë me xharafetë.
- 35 Pa e ushtrojnë çupënë,
pa xallahitnë ni me ni,
pa sanë: «Mëmo,
ky jut çupë nuk isht sëmurë,
po ishtë për vjezor.»
Rec. Magdalena Moskova.

c.

- 40 Tashti djymbëzjetë vjeç,
ne era, mëmo, ne djela.
Pa u sëmur çupa,
pa sëritnë, mëmo, heqimetë,
heqimet me xharafetë.
- 45 Pa heqimetë sanë,
se «kuju çupë nuk ishtë sëmurë,
po ishtë për vjezorë.»
«Kur sëmurem, mëmo, papë,
mos sëritni heqimetë,
- 50 heqimet me xharafetë,
po sëritni timenë trim,
timenë trim Vasillaqnë.
Pa kur vdesi, mëmo-lo,
të më bëjë, mëmo, ni sjundyk,
- 55 pa t'e shtroj, mëmo, me flori;
pa t'më veni dë sjyndyku
ze të më mbloni, mëmo».

Ana.

Rec. Jans Tytynxhieva.

3.

TATJA VATE DË KURBET...

a.

- Mëmo-lo, mëmo bukorë,
tatja vate dë kurbet.
- 60 Tatja vate dë kurbet,
pa më suall ni kuqe mollë.
Bullja me harapçen
zenë të më kaskandisnë.
- 65 pa më muarnë, mëmo,
pa më shpunë dë ni lartë kodrë,
dë ni sellë prua;
pa më hapnë ni sellë gropë,
pa më mblonë, mëmo,
d'at sellë gropë.
- 70 Pa më duall, mëmo,
dë mes dë zëmërë ni shimshir.
Pa shkojti andej, mëmo, ni çoban,
pa e preu atë shimshir,
pa e bëri ni kavall.
- 75 Pa kur curitesh, mëmo,
jeta argallandisesh!
Ah! çoban, çoban!
Të shkosh nga mëmësë porta,
pa t'sosh times mëmë
- 80 ku jam mbluarë,
pa t'më di timeja mëmë
ku jam mbluarë unë!
Anë.
Rec. S. Tabakçieva.

b.

- Tatja kur vate dë kurbet,
më suall ni kuqe mollë
- 85 kuqe-si, mollë argjentë.
Pa më kaskandisi bulja,
bulja, mëmo, me harapçenë.
Pa më muarnë më shpunë
lart-si, mëmo, dë ni ballkan.
- 90 Lart-si, mëmo, dë ni ballkan,
pa hapnë ni sellë gropë,
pa më mbluonë, mëmo.
Pa dju dit më duall
në krue ni shimshir.
- 95 Pa shkojti toni çobance,
pa e preu atë shimshir,

- pa e bëri-si, mëmo, ni kavall.
 Pa kur suritish,
 jeta drizenish,
 100 qiellt' argallandisenish!
 Ana.
 Rec. Maria Llambrua Popova.

c.

- Mëmo-lo, mëmo bukorë,
 tatja kur vate dë kurbet,
 tatja kur vate dë kurbet,
 pa kur më suoll, mëmo-lo,
 105 ni kuqe mollë argjentë.
 Pa më kaskandisi bûlia.
 pa më kaskandisi bûlia,
 bûlia me pashajkonë.
 Pa më muarnë, mëmo-lo,
 110 pa më shpunë-si, mëmo-lo,
 dë ni lartë lartë kodrë,
 dë ni sellë sellë pruvë.
 Pa hapnë-si, mëmo-lo,
 ni sellë sellë gropë-si,
 115 pa më mblonë-si atië.
 Pas tri dit-si, mëmo-lo,
 mbiu-si, mëmo, ni shimshirçe.
 mbiu-si, mëmo, ni shimshirçe.
 Pa shkojti toni çobançe,
 pa e preu-si shimshirçe-sin,
 120 pa e bëri ni kavallçe,
 pa e bëri ni kavallçe.
 Pa kur cJORITISH, mëmo-lo,
 pa kur cJORITISH, mëmo-lo,
 jeta argallandisenish!
 Kënd. Ana Mullushit (regjistruar në manjetofon).

4.

NGA POSHTË VINË, STANO...

a.

- 125 «Nga poshtë vine, Stano,
 tri turke me tri robinka.
 Për konak pjosnë, Stano:
 t'i japmë-him-li konak, Stano?»
 Stano sotë: «Jepni, mëmo, konak.
 130 Tatja e bëka konaknë
 për t'i japmë konak.»

- Turketë ndëjtkan
për të hanë bukë.
të hanë ze të pinë.
- 135 Hëngërkanë ze pikanë,
apëk robinkerat
jitkan divan.
Sënkani: «Pse nuk hani
juve robinkera?
- 140 — Kush të hamë, Stano, neve?
Tontë bura i muarnë
pa i zbuarnë,
pëp neve ni muarnë
robinkera.
- 145 Tontë djemtëza, Stano,
janë dë uzëratë,
guxhuvillafe, rاسباسانه:
ku të shohnë
ni furrë që digjetë,
- 150 atje sulenë
për ni copkë bukë.
O t'kaj-li kabil, Stano,
o t'mundesh ti ni shpëtosh?»
Stanua i sa-him:
- 155 «Munt ti vi shpëton.
Dilni jashtë
për të munt të merni uzë,
të ikni pë s'largu.»
Ze duallnë pa iknë,
- 160 pa u shpëtuanë.
Anë.
Rec. S. Tabakçieva.

b.

- «Stano-lo, mari bukorë,
nga poshtë vijnë, Stano-lo,
tri turqe me tri robinera.
— Mëmo-lo, mëmo bukorë,
- 165 t'i japmë-him-li konak?
— Kush mos i japmë-him konak?
Tatja ishtë fshatit çorbaxhi,
xhakua ishtë fshatit haznatar.»
I za-him konak Stanua,
- 170 pa ndëjtnë të hanë ze të pinë.
Robinerat divan itishnë,
pa i sotë-him Stanua:
«Pse nukë rini
të hani ze të pini?
- 175 — Stano-lo, mari bukorë,
kush të rimë

- të ham' eze të pimë?
 Tontë djemëza prëmë
 ranë-si me mëmë ze me tatë,
 180 këtënë mëngjes kur u ngritnë,
 guxhugafe, rاسباسانه.»

Ana.

Rec. M. Ll. Popova.

5.

DIMÇO-LO, BIRO-LO, DIMÇO-LO...

a.

- «Dimço-lo, biro-lo, Dimço-lo,
 nukë-li gjigjesh, biro-lo,
 lart dë lartmi mëhallë,
 185 dë hambari-si poprellkë,
 që rinë çupa me trima?
 — Gjigjem-si, mëmo-lo, dilgon-si.
 Ushqemë kalnë, mëmo-lo,
 jepi ni shinik grurë
 190 ze ni kusi vjetërë verë.»
 Ushqejti mëm-hi kalnë.
 «Nxirmë kalnë, mëmo-lo,
 verë kaltjaknë dë kali.»
 Hipi kalnë Dimçua,
 195 vëri mahernë dë brezi,
 vëri tjufeknë dë krahë,
 pa vat dë hambari poprellkë.
 «Mirëmbërëmani, jordashllar.»
 Donera nuk i mor selamnë.
 200 Nai togli djalë, Stojani,
 ay i muar selamnë.
 Zbriti nga kali Dimçua,
 qiti mahernë nga brezi,
 zbriti tjufeknë nga kraha,
 205 pa i seri gjis.

Ana.

Rec. M. Ll. Popova.

b.

- «Dimço-lo, biro-lo, Dimço-lo,
 nukë-li gjigjesh, biro-lo,
 lart dë lartmi mëhallë,
 210 që rinë çupa me trima,
 dë hambari-si poprellkë?»
 Dimçua i za-hi kalit-si
 ni shinik jelp
 ze ni shinik verë.
 Hipi kalnë Dimçua,

- 215 vate dë lart mëhallë.
 Nai togli çupë za-hi selamnë.
 Dimçua qiti-si kllëçnë,
 gjithizë çupa ze djemtë i seri,
 pa la nai toglënë çupë,
 220 që i za selamnë.

Ana.

Këndoi Dili Çankov.

6.

KALINKO, BUKORË KALINKO...

- «Kalinko, bukorë Kalinko,
 tashti nëntë vjeç, Kalinko,
 nëntë prushkufallë kalbe
 225 ze nëntë shtrofka kalbe.
 — Mëmo-lo, mëmo bukorë,
 kur ni mbloz mbreti dë sefer,
 pa kur u ksyemë, mëmo-lo,
 gjetmë nëntë dejman,
 230 pa kur i zasha zjarnë,
 pa kur blarinishnë qengjetë,
 vesë vesonish, mëmo-lo,
 kalsërë flakë dilish.
 Pa jermë më këtej, mëmo,
 235 pa gjetmë nëntë hambare,
 nëntë hambare plot grurë,
 pa kur i zasha zjarnë,
 gjelbërë flakë dilish.
 Pa jermë më këtej, mëmo,
 240 pa gjetmë ni barsë gruvë,
 pa e shqepa, mëmo,
 pa e qita këzannë,
 pa e hoza, mëmo, dë lartë,
 pa e mbajta mahernë,
 225 pa e podita këzanë.
 — Kalinko, bukorë Kalinko,
 sa holqë ze aqë të helqë!
 Me gjilpërësë malë të kumbisesh,
 nga hunazësë dupkë të shkosh!»

Ana.

Rec. M. Ll. Popova.

7.

NUKU TË VJEN KEQ, MATE...

- 250 «Mate-le, mari bukorë,
nuku të vjen keq. Mate,
këtille'e bukorë verës kohë?
— Ze të më vij'keq, mëmo-lo,
kollaj nuk ka, mëmo.
- 255 Mua më kalesnë, mëmo,
dë mazi malë, mëmo,
dë vjetëra fshat.
— Mate-le, mari bukore,
nuku të vjen keq, Mate,
- 260 tindija mashkulli djalë?
— Ze të më vij'keq, mëmo,
kollaj nuk ka.
Mua më bëjnë shtëpi, mëmo,
pa dyver ze pa qepengje.
- 265 Mere-si, mëmo, këzannë,
pa ecë dë du uzëra dë mesi,
bëj-si, mëmo, korlajkënë
dë du uzëra dë mesi:
kur bjerë shi,
- 270 këzannë o t'e kallpatë,
kur shkojë bletka,
o t'e puduvitë,
kur shtillet bairi
ze këzannë o t'e shtjellë.»

Ana.

Rec. M. Ll. Popova.

8.

HAJDE JANKO, HAJDE BIRO...

- 275 «Hajde Janko, hajde biro,
pashaj të sëret-si,
ferman të të japë,
lufe të të shkruaj.
— Mëmo-lo, mëmo bukorë,
- 280 nuk më sëret pashaj, mëmo,
ferman të më japë,
lufe të më shkruoj;
pa më sëret pashaj
kruven të më marë.
- 285 Dje në mëngjes vajta
dë të raja çesme,
dë të ngushta sokak,
të putis kalënë;
pa kleka atje pashajit nuse

- 290 me bila-hinë, mëmo,
pa u shkopcit kalit kullani,
pa u zagaçit-si, mëmo-lo,
nga nusesë ruoza, mëmo,
nga bila-hisë merxhani.
- 295 — Hajde Janko, hajde biro,
dyqan dë dyqan,
çarshi dë çarshi!»
Ana.
Rec. M. Ll. Popova.

9.

U MBET RISANUA PA MËMË, PA TATE..!

- Risano-lo, mari bukorë,
u mbet Risanua pa mëmë, pa tate,
300 pa e ritnë Risanonë vëllazëratë
gjer dymbëzjetë vjeç.
Risanonë e vlojtnë toçkërë,
pa jernë-si t'e marnë.
Pa i sotë Risanua baterave:
- 305 «Fshimëni, batera, fshimëni!
— Risano-lo, mari bukorë,
tin' nuk je mëndafshte testembel,
pa t'të vëjmë dë brezi;
nuk jesh argjendë mollë,
310 pa t'të vëjmë dë gji.»
Ana
Rec. dhe këndoi M. Ll. Popova.

10.

BILBILI KËNDON DË SHKOZË...

- Bilbili këndon dë shkozë,
bilbili ka bukor çupë.
O t'e vras, pa t'e mar-hisi,
t'e mar bukorë çupë.
Rec. D. Çankov.

11

ENGJELINKO, TOGLË ÇUPË...

- 315 «Engjelinko, toglë çupë,
pse ishe atju anës detit,
anës detit, sipër dë guri?
— Ushtron-si, mari, detit cëron,
detit cëron, pallamide.

- 320 Jer-si gjemixiu, sandakçiu,
pa më vuri dë kaiku,
pa më shpuri dë jatër mbret,
pa më vlonë, pa më martonë.
Tashti tri vjet sëmurë jam.»
- 325 Gjisë komshijetë sojnë:
«Aju jer-si me sumundë.
T'e zavitni me plafnë,
pa t'e hizni dë deti,
pa t'e hanë detit cëron,
330 detit cëron, pallamidet.»
Pa duoll-si maze furtunë,
maze furtunë me jerë,
pa luojtën detit dallgën,
pa e hoznë çupënë
335 dallgantë dë kumi.
Dë kumi pa u zgjuvejt çupa,
pa ushtroka dy çobankëza.
«O çobançe, çobançe-le,
toni fshat tutja-li ishtë?
- 340 — Ishtë, mëri, gjumsë sahat.
— Të veni t'i thoni timit tate,
me rëbënë të më marë.
Tashti jam tri vjeç sumurë,
sumurë s'un të jecën.»
- 345 Neri çoban vajtka i thënka-hi:
«Të vinë të më marnë,
unë jam sumurë.»
Vatkan e markan çupënë.
«Tinë nukë je çupë,
350 tinë je gruvë!
— Mëmo-lo, mëmo bukorë-si,
unë vajta të shoh
detit cëron, pallamide,
pa më muor kaikçiu,
355 pa më shpunë dë jatër mbret
pa më shtefanosnë, më martuan.»
Anë.
Rec. D. Çankov.

12.

MILKE-LE, MARI BUKORË...

a.

- «Millke-le, mari bukorë,
jernë të të kërkonjë;
të të japmë-li, mari Millke-le?
360 — A n'doni, mëmo, jepmëni.
Millkeja ishtë toçkërë,
Millkeja hanë s'un ksej.

- Millke-le, mari bukorë,
ze zoktë janë toçkëra,
365 ze zoktë bëjnë holenka,
ze zoktë qitnë javrume.»
Ana.
Rec. J. Tytynxhieva.

b.

- «Millke-le, mari bukorë,
jernë ti të të kërkojnë.
Jernë ti të të kërkojnë,
370 të të japmë-li Millke-le?
— Mëmo-lo, mari bukorë,
jepmëni, mëmo, jepmëni.
— Millke-le, mari bukorë,
tinë jesh Millke-le toçkëre.
375 Tinë jesh Millke-le toçkëre,
tinë zamat mundësh të ksesh.
—Mëmo-lo, mari bukorë,
ze zoktë janë toçkëra.»
Kënd. Elena Majkova (regjistruar në manjetofon).

13.

ÇË ËNDËR, MËMO, ËNDËRITA...

- Çë ëndër, mëmo, ëndërita:
380 dë mes të verësë kohë,
rënka-si, mëmo, ni zborë;
pas cingë, duoll djellkë,
pa e shtreti, mëmo, at zborë;
pa jernë, mëmo, tri lumëra:
385 dë trit lumëra anames
kish, mëmo, ni kodrë;
dë at kodrë, mëmo, ni gërvan:
hem llotëronesh, hem këndonesh.
Jit, mëmo, të të ekshigjis ëndërnë.
390 Zbora ishtë timja sumurlik,
djella ishtë timja shpirt,
ajo kodra ishtë timja var,
gërvan ishtë prifti-si,
q'o t'më llotëroj, q'o t'më këndo.
Ana.
Rec. J. Tytynxhieva.

14.

TUDORQË, BUKOR TUDORQË...

- 395 «Tudorqe, bukor Tudorqe,
mari ngro-si, Tudorqe.
Ngro-si nesër sabale,
pa t'mbrush, pa t'pjeksh
ngroftat kulaçe,
- 400 pa t'vemi dë mëm-hi dë mik.»
Pa u ngrit Tudorkja,
pa mbrujti ze poqi
ngroftatë kulaçe,
pa u nisë Tudorkja, u nisë,
- 405 pa u nisë të venë
me Karaxhanë
dë mëm-hi dë mik.
Pa vanë, vanë me kuçen kalë
gjer te gjumsë uzë,
- 410 pa gietnë ni toftë ujë
ze ni trashë sjankë.
Pa Karaxhau i sa-hi Tudorqes:
«Unë o t'bjë të shprihem,
ti ushtro ni ka poshtë ni ka lart.
- 415 Pa kur shohësh me bardë kalë
që epen ka uza.
të më ngrësh, Tudorqe,
unë me ni o t'i vras.»
Ze Karaxhau rënka të shtrihet.
- 420 Pa Turdoqja që vinë ka poshtë
me bardë kalë, pa i sa-hi:
«Ngro, Karaxha, ngro!
Vinë nga poshtë
dju barda kvol me dju hajdutë:
- 425 tju, Karaxha, o t'të vrasnë,
mua pë robinkë o t'më marnë.
— Ushtroj, Tudorqe, ushtroj,
mos janë tindetë vëllazëra.»
Tudorqja sotë. «Nuk janë.»
- 430 Pa u ngrit Karaxhai,
pa mor tyfeknë,
pa i vrau djytë.
Pa kur vanë panë
Karaxhau me Tudorqenë,
- 435 pa i panë vrratë bota,
pa cëngëriti ze piskati Turdokja:
«Çime-si bëmë, Karaxha,
çime-si bëmë!
Këta klekanë timetë vëllazëra!»
- 440 Pa ngritnë Tudorkja me Karaxhanë,
pa hipnë-si kuçenë kalë,
pa vanë dë mëm-hi dë mik.

- Duoll mëm-hi t'i karshalladisë,
 pa e pjoti-si Tudorkja:
 445 «Ku janë, mëmo, timet vllazëra?»
 Pa mëm-hi i sa-hi:
 «Tindet vllazëra, Tudorqe,
 jernë të të karshalladisnë.
 Nuku i karshalladise, Tudorqe?»
 450 Pra i sotë Tudorkja mëmësë:
 «Sëllmë, mëmo, mahernë,
 kam-si ni kuqe mollë,
 t'e pres, mëmo, t'e hamë.»
 Pa e mor Tudorkja mahernë,
 455 pa u mbërsye të zëmër.
 «Q'o t'zhalitësh mëmo, dju,
 të zhalitësh tri!»
 Karaxhau mor mahernë,
 pa i sotë-hi babo-his:
 460 «Babo-lo, bukorë babo,
 q'o t'zhalitësh tritë,
 të zhalitësh katërtë!»
 Pa u vra ze Karaxhaj.
 Rec. E. Majkova dhe Katina Petrova.

15.

JAK TË TË VLOJMË, MITE-LE...

- «Jak të të vlojmë, Mite-le,
 465 për bash çorbaxhiut çupë.
 ze për kadënën mavrutë.
 — Mos më nda, tate, mos më nda,
 nga timet të bukura arkadash!»
 Pa e vloka tati ze e martuoka.
 470 Bëri ca pak shumë kohë,
 i duoll Mitesë ni erà,
 të sollaku anë, të zëmërrë.
 Pa i sotë tatjesë:
 «Tate, tate bukorë,
 475 gjemë derman, tate,
 të më shkoj eràja!
 — Jecë-si, Mite, jecë-si
 të mukadëri mazit fshat;
 atje ka të mëza heqime,
 480 të të shkojnë erënë.»
 U ngrit Mitja pa vate,
 nuk i gjet heqimetë.
 U ksye prapë Mitja,
 pa vate të halë-hi Erinua.
 485 «Halë, halë-le bukorë,
 hapmë derën, halë-le!
 Të më shtrosh, halë-le,
 të glatë ze të gjerë!»
 Pa i shtrojti hal-hi

- 490 dë glatë sa dë gjerë.
 Pa ra-si Mitja të dergjetë,
 pa i duall Mites shpirti.
 Ana.
 Rec. dhe kënd. Stano Gjençosë, Ristosë gruvë.

16.

TRI TË BELIKUT ÇOBANË...

- Tri të belikut çobanë
 vetkan dë Tudorua,
 495 hëngërkan ze pikanë,
 nga butja verënë soskanë,
 verënë së bardë ze rakinë.
 «Mari jakë, jakë Tudoro,
 të të pagojmë hakënë.
 500 — Po dua nai toglën çobançe
 me shkrorënë kavallçe
 ze me zezënë kallpakçe.
 — Mari jakë, jakë Tudoro,
 të të pagojmë hakënë.
 505 — Un' nuk e dua hakënë.
 — Çobani ishtë vluorë
 për ni hollë bardë gërqn'je.
 — Gëneni. Cilëndo gëneni,
 Tudoronë mos e gëneni.
 510 Tudorua juve vi n'joh
 nga sjutë ze nga surati.»
 Rec. Trisa Gjeorgjeva Gjençeva.

17.

SE NUKU NDROHE, ZLLATE-LE...

- «Zllate-le, mari bukorë,
 se nuku ndrohe, Zllate-le?
 Se nuku ndrohe, Zllate-le,
 515 tindetë roba Zllate-le,
 muhla i hëngërë, Zllate-le.
 — Mëmo-lo, mëmo bukorë,
 kush të ndrohem, mëmo-lo?
 Duneri nuk më pjosin!
 520 Ato, mëmo-lo, mblizenë,
 çupa me trima, mëmo-lo,
 çupa me trima, mëmo-lo!
 — Mos ki kahër, Zllate mari.
 — Kush mos kem kahër, mëmo-lo?
 525 Nuk më pjosnë mua, mëmo-lo!»
 Kënd. Majdalino Toska.

SHTOJ CË

1.

NE JERA, MËMO, NE DJELA...

- Ne jera, mëmo, ne djela,
tashti djumbëzjetë vjeç,
që u sumur-si çupa.
Pa sëritnë heqimetë,
530 heqimetë ze xharafetë,
të tandisnë çupënë.
Pa xallahitnë ni me ni:
«Kuju çupë bukorë
nuk ishtë-si sumurë,
535 po ishtë për vjezorë.»
Po i sot' o çupa mëm-hi-së:
«Mëmo-ljo, mëmo bukorë,
ze ni herë, kur sumurem-si,
540 mos sëritni heqimetë,
heqimetë ze xharafetë,
po të sëritni timen trim,
timen trim Vasillaqinë,
të më bëj' ni sjunduk, mëmo,
545 me argetatë nahtarë,
me florin d'atë kljuçë;
të më vëni dë sjundjuku,
të më kulçitni-si mirë,
pa të më hizni dë deti.»
Mbl. nga një mandricar.

2.

STANOS KËNKË

- 550 Zea u tunt, deti u luçnit,
pa u mbutne nënte kazen bota,
pa u mbet Stanua me trimenin,
pa i za-him Perëndija mashkull djal',
mashkull djal', mençme djal'.
Pa u përgjegj mu de Stamboll,
555 de mbreti Kostantin.
Pa dergojti mbreti tri ullane,
tri katare,
pa vane de Stanos obore,
pa gjetne Stano ze eëndish
560 hollë pëlhure,
pa i sane Stanos:
«Stane, mori bukur Stano,
tine paske mashkull djal',
mashkull djal', mençme djal',
565 te kerkon ti Stano mbreti,
mbreti Kostantin.»

Stano sote: «S'is(h)t'e maze
kualt te putise ze te shkruhe.

— Une nuk e kerkon

- 570 kualt te potise ze te shkruhe.
po dua te vij' pran' de mua.
mbreterlik t'i jape.»

Mbl. nga Kolë Jakova.

SHËNIME MBI KËNGËT

1) *Ushtrosh*, vështrosh. 2) *Ni çime*, një kaq... 3) *Pës*, posi. 3) *Kush*, qysh. 15) *Ne jerë, ne djelë*, as erë, as djellë. 18) *Xharah*, mjek operator popullor. 19) *Të xallahijnë*, të flasin. 22) *Përë vjezorë*. për të vjedhur. 24) *Trim*, djalë, këtu: i dashur. 26) *Merixhi*, lumi Marica, tq. 30) *Tashi djumbëzjetë vjeç*, tani e dymbëdhjetë vjet. 36) *Ni me ni*, njëri me tjetrin, shoq me shoq. 48) *Papë*, prapë. 53) *Pa kur vdesi*, pa kur të vdes unë. 59) *Tatja*, babai. 62) *Bulja me harapçen*, motra e madhe me burrin e saj, i cili ishte i zi («burri motrës zezë kleka», shpiegon S. Tabakçieva). 63) *Të më kaskandisnë*, të më tallin. 68) *Pa më mblonë*, pa më mbuluan. 73) *Shimshir*, bush. 75) *Kur curitesh*, kur frynte (fylli). 76) *Jeta argallandisesh*, bota dridhej. 89). *Ballkan*, mal. 99) *Drize-nish*, dridhej. 108) *Pashajkonë*, i shoqi i të motrës qe pasha. 112) *Pruvé*, përrua. 126) *Tri turke me tri robinka*, tri turq me tri robëresha. 127) *Pjosnë*, pyesin. 136). *Apëk*, ndërsa, kurse. 142) *I zbuarnë*, i zhdukne, i vranë. 143) *Pëp neve ni*, kurse ne na i... 146) *Janë dë uzëratë*, janë nëpër udhët, rrugëve. 147) *Guxhugllafe, rاسباسانه*, kryejashtë të rrecosur. 152) *O t'kaj-li kabil*, do të kesh mundësi, do të mundesh. 153) *Ti ni shpëtosh*, të na shpëtosh. 155) *Munt ti vi*, mund të ju... 167) *Fshatit çorbaxhi*, pasaniku, i pari i fshatit. 168) *Xhakua*, xhaxhai; *haznatar*, këtu: epitrop. 172) *Itishnë*, flisnin, ishin. 178) *Prëmë*, mbrëmë. 183) *Nukë-li gjigjesh*, a nuk dëgjon? 185) *Poprellkë*, punë së bashku. 186) *Dilgon-si*, unë dëgjonj, po dëgjonj. 193) *Kaltjaknë*, shalë. 198) *Jordashllar*, shokë. 199) *Donera*, ndonjëri, asnjëri. 200) *Nai togli*, më i vogli. 203) *Mahernë*, thikën. 202) *Tashti nëntë vjeç*, tani e nëntë vjet. 203) *Prushkufallë*, jastëkë. 225) *Shtrofka*, dyshekë. 227) *Ni mbloz*, na mblodhi; *sefer*, luftë. 229) *Dejman*, vathë bagëtish. 230) *Çasha*, dhashë. 231) *Blarinishnë*, blegërinin. 234) *Jermë*, erdhëm. 240) *Barsë gruvë*, grua me barrë. 241) *E shqepa*, e preva. 242) *Këzannë*, fëmijën. 245) *Pobita*, shpova, 247) *Holqe*, hoqe; *të helqe*, të hiqje. 248) *Me gjilpërësë malë të kumbisesh*, më të gjilpërës majë të qëndrosh. 249) *Dupkë*, vrimë. 252) *Verës kohë*, verë, stinë e verës. 254) *Kollaj nuk ka*, lehtë s'është, s'kam si bëj. 255) *Më kalesnë*, më kallën, më varrosën. 260) *Mashkulli djalë*, djali, biri. 264) *Qepengje*, qepena, kanata. 266) *Dë du uzëra dë mesi*, në mes dy udhësh, në një kryqëzim udhësh. 267) *Kolajkënë*, kunën, hamakun. 270) *Kallpatë*, lajë. 272) *Puduvitë*, mandë, t'japë sisë. 273) *Shtillet bairi*, mbështillet, mbushet me gjeth pylli. 278) *Lufe të të shkruaj*, ylefe, rrogë të të shënojë, të të japë. 288) *Putis*, jap ujë. 290) *Me bila-hinë*, me të bijën. 292) *U zagaçit-si*, na u tremb. 294) *Merxhani*, korali. 297) *Çarshi*, pazar. 302) *E vlojtnë toçkërë*, e fejuan të vogël. 303) *Pa jernë-si*, pa na erdhën. 304) *Baterave*, shoqeve? krushqërve? 313) *T'e mar-hisi*. t'ia marr unë atë. 318) *Ushtron-si mari*, detit çeron, po vështronj (vështronja), moj, peshqit e detit. 319) *Pallamide*,

lloj peshku deti. 320) *Sandakçiu*, varkëtari. 322) *Dë jatër mbret*, në (një) tjetër vend, mbretëri. 326) *T'e zavitni me plajnë*, ta mbështillni me belcën. 356) *Shtefanosnë*, vunë kurorë. 360) *A n'doni*, po të doni. 361) *Toçkërë*, i vogël. 362) *Hanë s'un ksej*, në shtëpi nuk mund të kthejë. 365) *Holenka*, folera. 366) *Javrume*, të vegjël. 382) *Pas cingë*, pas pak. 385) *Dë tri lumëra anames*, në mes të tri lumenjve. 387) *Gàrvan*, korb. 388) *Llotëronesh*, vinte rrotull. 389) *Jit*, qëndro; ekshigjis, interpretoj. 390) *Sumurluk*, sëmundje. 396) *Mari ngro-si*, ngremu moj. 400) *Dë mëm-hi dë mik*, në e ëma në mik, te nëna jote për mik. 410) *Toftë*, të ftohtë. 411) *Sjankë*, hije. 413) *Shprihem*, shplodhem. 414) *Ni ka poshtë ni ka lart*, një (herë) nga poshtë, një (herë) nga lart. 416) *Që epen ka uza*, që duken, që vinë nga udha. 418) *Me ni*, me një herë. 424) *Barda kvol*, kuaj të bardhë. 432) *I vrau djytë*, i vrau të dy. 435) *Vraratë bota*, njerzit e vrarë. 436) *Cingëriti ze piskati*, bërtiti dhe klithi. 437) *Çime-si bëmë*, çfarë bëmë ne. 440) *Pa ngritnë*, pa u ngritën. 443) *T'i karshalladisë*, t'i takojë, t'i presë. 456) *Q'o t'zhalitësh*, që do të qash, atje ku të qash. 457) *Babo-his*, gjyshesh së saj, gruas plakë (nënës së Tudorqes). 466) *Kadënën mavrutë*, zonjën ezmore. 468) *Arkadash*, shokë. 470) *Ca pak shumë kohë*, ca kohë, as shumë as pak. 471) *Erà*, plagë. 472) *Sollaku anë*, ana e majtë. 478) *Mukadëri*, 484) *Dë hal-hi*, te halla e tij. 488) *Dë glatë ze dë gjerë*, së gjati dhe së gjeri. 439) *Të belikut*, të shtetit, të pasurisë së shtetit. 501) *Me shkrorënë kavallçe*, me fyellin të shkruar. 502) *Kallpakçe*, kallpak, qylaf. 507) *Gërçin'je*, greke. 519) *Dumeri nuk më pjosin*, asnjëri nuk më pyet, nuk pyet për mua. 523) *Kahër*, ankim, të keq.

PËRRALLA

1.

ZËNDËRIT MASALLA

1. Ni kohë, ni djalë u vloka dë jatër fshat, dë Gjushqunar. 2. Ni dit rënka shumë shi. 3. U niska dë mëhallëaju. 4. Kur vatka, qit robotë, bëhet gollopar.

5. Nusja: «Popo!» 6. Bëjnë zjar, q'o t'vejë zëndëri të shtunë për të djelënë.

7. Zëndëri, kur vatka dë shtëpi, vesh robotë jashtë. 8. Kur hika brënda, nusja e ngatka kushtu, mos ishtë lagëta:aju s'paska lagëtë. 9. Nusja sënka: «Kaçe shi binish, kush nuk u lakke?» 10. Aju sënka: «Unë nuk klesha budalla, ku pikon atje të shkel; ku nuk pikon, atje shkeln'ja pa nuk u lakça.» 11. Sënkani ato: «Toni zëndër shumë mëncime.»

12. Atë natë bëjnë gjellë sier... 13. Pëstaj rënka të flinë.

14. Në mëngjesit, presnë zëndërë të ngrihetë, nuku ngrihetë. 15. Çupa me ima-hinë xallahitkan djutë: «Toni zëndër pës me neve bota nuku xallahin? Të sëresim priftin.» 16. Po aju nga plafi gjeqka. 17. Aju mentotka që t'i soj priftit. 18. I erdëka dër mënt të soj ni ëndër.

19. Vete prifti i sotë: «Nuk ngrihe, zëndër, me që u gëzi?» 20. Aju i sënka: «Prift, prift, çime ëndër ëndërita!» 21. Prifti sot: «Çar ëndër ëndërite? Soje.» 22. Zëndëri zënka t'i anastisë-hi ëndëren priftit:

23. «Prift, prift, anës së deti kish ni kavak; së kavaku kish ni kokove; së kokove kish ni gjilpërë; së gjilpërë siprë kish ni sini; së sini siprë klesha unë! 24. Kur frunish jëra, ngrihen'ja un' së qielltë! 25. Tin', prift, të kleshe ndë tim vënt, çë kesh bësh?» 26. Prifti sënka: »Un' gëzitem.» 27. Zëndëri sënka: «Po un' çë kam bën sot?»

28. Prifti sotë: «Hajde, babo, mer ti fshesënë, ti nuse bardikënë, pa lan'je.» 29. E lakan.

30. Pa jatër herë zëndëri në shi mos niset ze sier mos hajë.

Tregoi Urania Majkova.

2.

MAROS MASALLA

1. Ni kohë, ni mëma paska dju çupa; neri vetiut, neri mashtahë.
2. Pëstaj s'e dashka nëna atë çupë, Maron, mashtahënë.

3. Për dru e shpienë. 4. Hima-hi i bëkaj kulaçe. 5. Venë pëstaj me tatjen për dru. 6. Marua kërkon ujë, tat-hi sotë: «Të ngërkojmë rābënë dru». 7. Ngërkojtkan rābën dru, pëstaj t'rukullit kulaçen së prru. 8. «Ku të mbahet kulaça, atje ka ujë», tat-hi sa. 9. Marua u nis të gjejë ujënë, tat-hi mbrejti rābënë, iku.

10. Kur duall Marua sipërë së lartë, s'ka tatë. 11. Niska të klaj. 12. E gjen sërna, i sotë: «Pse klash?» 13. «Tatja më la vetëzë!» 14. «Mba piqinë, të të bën ni sërnichë.»

15. E mer Marua sërnichën e vete së mulli. 16. Kur çil derën e mullisë Marua, venë xëngërmaroratë: «Hape derënë, Maro.» 17. Aju nuk e hapka. 18. I sënka: «O t'u thom ni masallë.» 19. I sënka kërpi të tërë masallë. 20. Kërpinë e mbjellka, e prashitka, e qitka, e vëka së ujë, e menitka, e tjerrka, e mbëshjtjellka, e juvejka, e bitiska. 21. Pëstaj këndon kadesi. 22. Ato xëngërmarorat që ka gjoli, ikkan, u zbjerkan. 23. Marua u shpëtua veçe.

24. Pëstaj vatka ni baboz të laj robotë e kleka qorçezë, nukë ditka: vë kazanë praptan së vërnice; shtika ujë, nuku mba kazan, rjeska. Zbret Marua, e vë kazanë mirë. 26. Mer Marua, i la-hi robotë asajt babo, pëstaj mer guatënë Marua, e shpje mu shpi-him. 27. Babo i jep bakshish ni bardë kalë, barda roba, i jep ze ni shinik flori, e dërgon së shpi-him.

28. Kur u niska të vejë Marua, qeni xhaulitka, sënka: «Toni Maro vjen! Vjen me bardë kalë, me bardë hustan, me ni shinik flori!» 29. Mëm-hi sënka: «Ho merit! Ton Maro e hëngrënë karkanxollet, i zavitnë zorat së pernicë.» 30. Pëstaj këndon kadesi: «Qirqirigu! Toni Maro vjen me bardë kalë, me bardë hustan, me nishinik flori!» 31. Sënka mëm-hi: «Ksho, merit! Maron e hëngërën karkanxollet.» 32. Marua vatka së shtëpi me bardën kalë, me bardën hustan, me ni shinik flori.

33. Mëm-hi dërgon vetiut çupë së mulli. 34. Karkanxollet, kur i topitkan-hi derënë, — «Hape derënë, Tudoro!» — aji e hapka derënë, e hëngërkan karkanxollet.

35. Qni zhualitka: «Tonë Tudorë e hëngërnë karkaxollet!» 36. Ima-hi i sënka: «Ho, meret! Tudorua vjen! Vjen me bardë kalë, me bardë hustan, me ni shinik flori.» 37. Kandesi ze aju atë sotë: «Qir-qirigu! Tudoronë e hëngërnë karkaxollet, i zavitnë zorat dë pernicë!» 38. «Ksho, meret! Tudorua vjen! Vjen me bardë kalë, me bardë hustan, me ni shinik flori.» 39. Bitisi.
Tregoi U. Majkova.

3.

DRAKOS MASALLA

1. Ni uduvicë gruvo mer djalëzën tej dë vreshtë. 2. Pa kur vatka dë vreshtë, e vënka djalënë dë sankë të ri. 3. Drakua vete e mer mëm-hin, pastaj ky djalëzë mbetetë. 4. Vete ni komshi e mer, i sotë: «Ku ishtë mëm-ti?» 5. «Jer ni neri e muor. Nuk e di ku ishtë.»

6. Mëm-hi shkon ca koh' me atë drako. 7. Kjy djalë ritet, bëhet maze. 8. Kur bëhet maze, pjot: «Mëma ku ishtë?» 9. Sojnë komshintë: «Drakua e muor.» 10. «Ku ron drakua » 11. I sojnë komshintë: «Ja ku ron. A mos veç atje! Aj o t'të haj.»

12. Pëstaj djali vete dë atë shtëpi ku kle mëm-hi, pa e sheh ima-hi, pa i sotë: «Ku jerçe, biro? Të ikish», sotë, «biro, se o t'të haj drakua!» 13. «O t'më fshehësh.» 14. «Ku t'të fsheh? Ai po dushit!» 15. Ze ai ikën. 16. «Mëmo, të më japësh zë kur ikën, o t'vjen të të mar.»

17. Mëm-hi sëmuret jenkas, pa pëstaj ushtron mëm-hi t'e zbjerë drakon. 18. Drakua, kur dashka të vdeska, pa i sa që «përandaj pjotn'je ti çom ngaha ron, të më japësh sëmurlik!» drakua i sotë. 19. Drakua, nga kahër, u sëmur; pëstaj drakua vdes.

20. Djali andej lloturohenish, gjer të vdesë drakua, të marë imahinë. 21. Vdiq drakua, mëm-hin e muor veçe, e shpëtojti nga dushmani. 22. Ana.

Tregoi Stano Gjençosë, Ristosë gruvë.

4.

MARAFLOS MASALLA

1. Tri motra klekan ze ni mëmë. 2. Sënkanë të hipin dë tavan të tjernë. 3. «Asat pen q'o t'këputetë, o t'e serëm, t'e hamë.» 4. U kuputka ima-his pen, pëstaj e serkan, pa e zjetkan, pa e hëngërkan. 5. Nai togli motër nuk hëngërka. 6. Kur hëngërkan jatratë, mbleskëza koskafë nai togli motër, i vëka dë panerkëzë, pa i vëka dë plëh, i mbloka mos i hanë qëntë koskëzatë...

7. Pëstaj jerdëka djela, motratë vanë dë klisë. 8. E sritkan ze Maraflonë, nai togli motrë që fshehu koskatë, e stritkanë dë klisë të ve, — nuk vatka. 9. U ndroka pëstaj Maraflua, pa vatka dë klisë.

10. Kur vatka dë klisë, gjis u shuetkan kandiletë, që ndrinish Maraflua. 11. Togllë mas, gjis e ushtrotkan, pa mbetkan çuditura insani.

12. Pëstaj prifti, kur zëka veqe duvanë, që t'lishoj klisha, ajo dalka, vatka-si më shpi-him, i qitka robotë, i vëka-si dë plëhë.

13. Pëstaja vatkan motratë mu shpi-him nga klisha, pëstaj i sënkan: «Maraflo, Maraflo, pse nuk jerçe dë klishë?» 14. Pëstaj i sënka: «Ç'o të bën do klishë të vjen? Unë roba s'kam.» 15. Pëstaj i sënkan: «Të shihn'je që erz ni çupë, që ndrinish klisha, që u shuetnë kandiletë.»

16. Pëstaj jerdëka pap djela, o t'venë pap dë klishë. 17. «Hajde, Maraflo, të vemë dë klishë. Munt vij aj çupë.» 18. «A ç'o t'bën un' që të vij dë klish'?» i sënka. «Jecëni juve.»

19. Vatkanë motrat dë klishë, pëstaj u ndroka papë Maraflua me ato roba, — i marka nga plëha, — pëstaj vatka dë klishë. 20. Dë pangari kleka ze mbreti. 21. Mbreti i sënka atyrmet bota, të mundnë t'e zëjnë çupënë. 22. Mir' amà, çupa shpëtohet, ikën, vete-si mu shpi-him. I qitka robotë papë, i vukaz dë plëhë.

23. Pëstaj i erdëkan motrat nga klisha, pa i sënkan: «Maraflo, Marflo, pse nuk jerçe dë klishë, të shohësh atë çupë?» 24. «Ç'do t'bën unë dë klishë? Nuk kam roba.»

25. Pëstaj jerdëka pap djela q'o t'venë dë klishë. 26. «Hajde, Maraflo, të vem dë klishë; munt vij papë.»

27. Ajo pëstaj u ndroka, pa vatka, — nuk vatka seftë. 28. Pëstaj klisha, q'o t'lishoj prifti, që o t'japë duvanë, — zëka shija, u mbetka me prapë cingë. 29. Pëstaj, nga nxitorë, bitiska dë baltërat: u mbetka nera kupucë!

30. Vete mbretit bir të putisë kalnë: e zbon kalnë, nuk vete. 31. «Be xhanëm, pse nuk vete kali?» 32. Zbritka nga kali, mer të helqë kalnë, kur ushtroj përpara ni kupucë që ndrin. 33. E qitka kupucënë, pa e vëka sipër dë çeshmë. 34. Pëstaj e mer kalnë e putis, e mer ze kupucën.

35. Vete-si mu shpi-him, lis kalnë, pa mbles tërë fshatit bota, pa t'veshnë kupucën t'shon cilit ishte ai kupucë. 36. Pëstaj donerit nuk ujdiska, pa sënkan Maraflos motra, që paskan ni Maraflo mu shpi-him, që nuk dashka të vej.

37. Pëstaj mbreti e mer kupucën, pa vete mu shpi-him. 38. Kur e veshi Maraflua kupucën, u qepka nga këmba. 39. Pëstaj mbreti sënka: «Un' o t'e mar këtë gruvë.»

40. Jerdëka sëra, u bëka lehonë grua-hi, paska ni djalëzë. 41. Bëhenë motratë avgjitka, pa i kërkojnë-hi bukë. 42. Ajo nuk u ksyeka, po u sënka: «Un' jam lehonë, nuk bën të jap bukë.» 43. «O t'më japsh», i sënka, «o t'më japësh bukë.» 44. Pëstaj i sënka-him: «Ze ujë o t'më japësh.» 45. I sënka-hi papë: «Qitni-si juve ujë nga bunari, un' nuk bën të qit.» 46. «Neve domë nga tju ujë.» 47. Pëstaj marka, qitka-him ujë, pa e gëtnikan dë bunari. 48. Pëstaj motra i vatka dë plafi, lehonëaju të ishte.

49. Vete mbreti, gjigjet këzani që kla. 50. «Pse kla këzani», sënka-hi. 51. «Kla», i sënka lehona. 52. E mer të gjedisë këzannë.

53. Pa dalka dë bunari mbreti me këzanë. 54. Dalka ni kuqe mollë nga bunari. 55. Kur dalka molla, këzani u gëzuoka, pushuoka. 56. E preka mbreti mollënë, këcyeka, rënka ni bulashkë dë bunari. 57. Pa vete ni babos, ujë të marë nga bunari, pa e sheh atë bulashkëzë herbàb: e marka për poçkënë të pulpitë.

58. Pëstaj jerdëka djela, vatka dë klishë baboza. 59. Kur u ksyeka nga klisha, gjetka gjissej hazërë: buka, gjella, fshira. 60. Pëstaj pjot-

ka dë komshikatë, cili bëri ato punëra. 61. Donera nuk i bëka. 62. Kur jerdëka djela papë, vete dë klishë, pa ndes qirintë, pa u ksyeka: fshihetë dë shpi-him. 63. Ajo gruvë që fshika, hes bublluketë, pa e sheh aj babozë, pa i sënka. «Tinë jesh, mari, që urtusitesh?» 64. Pëstaj hikan brënda, u llaftoskan, xallahitkan.

65. Pa e pjotka babua: «Kush jerçe kutu?» 66. Pa i sënka-hi: «Unë baba, jam mbretit gruvë. Jernë timetë motra, më kërkuanë bukë ze ujë pa më gërmisnë dë bunari. 67. Pa vate motra dë plafi, u gëçit, lehonë të bëhetë. 68. Pa vate mbreti e gjet këzannë që kla, pa sotë-hi: «Pse kla këzani?» 69. E mer mbreti këzannë, e nxjer jashtë dë bunari, pa duol ni mollë, — ajo mollë klesha unë», — sënka, —, «pa gëzohenish këzani dë mollë. 70. Pa e preu atë mollë mbreti, pa këcejti bulashka, pa e more tinë, babozë. 71. Bulashka jam unë. 72. Jec mer çof këzannë.»

73. Pëstaj vatka baboza, e marka këzannë, pa e zënka ima-hisë. 74. E puduvitka gjis ditënë ze fjetka.

75. Pritka, pritka mbreti t'e shpjerë baboza këzannë, nuk e shpu-ka. 76. Pëstaj mbreti vatka t'e marë-si. 77. Bëka të fshihet ima-hi, — mbretit gruvë, — mos e shohë mbreti. 78. E përftaska mbreti, e paka: nuk u fsheska. 79. Pa i sotë-hi mbreti babosë: «Babo, nukë-li klanish këzani?» 80. «Nuk klanish», i sa-hi. 81. Ksehetë babua pa i sotë: «Këzani mëmë ishtë kuju.» 82. «Ima-hi ishtë mu shpi», sënka mbreti. 83. Pa i anastis-hi mbretit që motrat u bëkan avgjitka, që i kërkuan bukë ze ujë; që bëke të qitë kohënë, e gëtnikan, e lishojnë dë bunari. 84. Pë pëstaj dalka ni mollë:aju kleka gruva, që u gëzoka këzani dë mollë.

85. Pëstaj marka gruva-him ze këzannë mbreti, pa venë mu shpi-him, pa i sënka: «Ngro nga plafi!» 86. Pa e përzen, e reh jatrën. 87. Bitisi. Anë.

Tregoi (dhe pjesërisht e regjistruam në manjetofon) J. A. Mu-llushit.

GJEZA

1. Ni shej: shpin'e mban dë krah, çë ishtë ai? — Zhellva.
2. Katrë vëllazëra sulen sulen, nuk arrihen, çë ishtë ai? — Ràba,
3. Ni shej: ka shkon, uzë bën, çë ishtë? — Shëlmeku.

SHËNIMET PËR PËRRALLAT DHE GJËZAT

ZËNDËRIT MASALLA

4) *Gollopar*, lakuriq. 12) *Sier*, thier. 15. *Djutë*, të dyja. 20) *Çime*, çfarë. 22) *Anastisë-hi*, t'i tregojë. 23) *Kavak*, plep. 26) *Gëzitem*, dhitem. 28) *Bardikënë*, bardhakun, shtëmbën.

MAROS MASALLA

1) *Mashtahà*, të gjetur, thjeshtër. 4) *Hima-hi*, e ëma. 12) *Sërna*, sor-kadhja. 14) *Sërnickë*, sorkadhe e vogël. 16) *Xëngërmarroratë*, lloj nin-fash. 20) *E qitka*, e shkulka. *E menitka*, e rrahka. *E juvejka*, e endka.

22) *U zbjerkan*, u zhdukkan. *Veçe*, tanimë. 24) *Praptan* të vërnice, së prapi mbi gurët. 26) *Guatënë*, govatën. 28) *Xhaulitka*, lehka. 29) *Ho, meret*, tyt, i shkretë! *Pernicë*, fletari i mullirit. 31) *Ksho, meret!* pusho, i shkretë! 33) *Vetiut*, të vetën. *Papë*, prapë.

DRAKOS MASALLA

1) *Uduvicë*, e ve. 2) *Sankë*, hije. 8) *Pjot*, pyet. 12) *Jerçe*, erdhe. 14) *Dushit*, merr erë. 18) *Dashka të vdeska*, do të vdeska. *Çom ngaharon*, nga se rron, nga të vjen jeta.

MARAFLOS MASALLA

3) *Asat pen q'o t'këputetë*, asaj që do t'i këputet peri. 6) *Panerkëzë*, shportë. 11) *Toglë mas*, i madh e i vogël. 12) *T'lishoj*, të mbarojë. 20) *Pangari*, vendi ku marrin e paguajnë qirinjtë. 28) *Me prapë cingë*, më prapa një çikë. 31) *Be*, bej. 47) *Gëtnikan*, shtykan. 57) *Herbàb*, e mirë, e aftë. *Pupitë*, mbulojë. 61) *Donera*, ndonjëra. 63) *Gruvë*, grua. *Bublluketë*, plehrat. 63) *Urtusitesh*, rregullon shtëpinë. 67) *U gëçit*, u shtri. 72) *Çoç*, pak. 83) *Kohënë*, kovën.

TRI GJEZA

1) *Shej*, shenjë. *Zhellva*, breshka. 3) *Shëlmeku*, kërmilli.

GOJËDHËNA MBI THEMELIMIN E MANDRICES

1.

1) Kur arthka Turqia kutu, ni toni shqiptar kleka dostafçik. 2. Pëstaj dërzhava u mbetka memlyn, pse kleka temis, neri mir, punuoka. 3. E pëlqyeka dërzhava. 4. Çë dosh nga neve? ai sënka. 5. «Time bera gjer ku ecinë, të ish timi, ze dënak mos pagoj, ne belik, ne pë ze asdogjë.» 6. Pëstaj dërzhava sënka: «Hellall. Ai vënt tindi ishtë. Nuk dua dënak, ne nishtu, asgjë nuk dua.» 7. Bëkan ahere shtëpi kutu: mëhallë bënë. 8. Pëstaj, kur mësoka kushëriu, që mbet kutu, — ai kleka prift, — me papzianë bashkë ze me djemtë ze me bilëjnë, erthnë kutu te kushuriu, të rojnë pranë, ndanë... 9. Unë aqe di... 10. Paskan djem... 11. Fshati u bë gjer dë katrë qint shtëpi, nga dju. 12. Pëstaj, at dokument që zënkaj Turku, e marnë, e grisnë, të pagojnë dënak!... 13. Aqe kam gjegjur nga pleqtë, nga xhako Postol Stojço. 14. Shum vjeç ka vdesur, më ni mil nëntë qint e shtata. 15. Aju kle neri që mba shumë mënt. 16. Shtatzet e pes vjeçme kle që vdesi, aqe kle. 17. Unë tetzet e dju vjeçme jam. 18. Di gërqisht: aqe di, potpismi. 19. Shklerisht di të potpis trimen ëmërë. 20. Kutu jam pjellë, dë Mandricë.

Tregoi Nasho Dakov.

2.

1. Tashti ashtu e sonë: jemi nga Viskuthi. 2. Përpara: Bithkuq. Tregoi N. Dakov.

3.

1. Timë tate më sonish: neve që kleqemi arnaute, klekemi nga Arnautllëku. 2. Paskan jerdurë dju veta, vllazërë, që therkanë mish asqeritë: klekan dostafçik. 3. Kur jerdëkan kutunë, dë këtë vënt, shkotkan këtëj, këtë vënt e bendiskan, e pëlqyekan mirë. 4. Kur aritkan dë Qutet atje, atje bëkan veqe stop. 5. Dytë vllazëra xallahitkanë ni me ni: «Nuk o t'vemë prapë dë velaeti.» 6. Pa sënkan: «Të vemi dë mbreti, t'shom ç'o t'i soj.» 7. Mbreti i sënka: «Nuk o t'veni-si prapë dë velæeti.» 8. Po aju sënka: «Neve nuk o t'veni-si prapë, o t'mbetemi kutu të rojmë. Ja ku ka ni vënt bukorë, e bendisme: atje o t'vemi të rojmë.» 9 Mbreti i sënka-him: «Këto bera që u mbetnë, merni, pa ecëni atje dë atë vënt që e bendistë, të roni atje, pse unë mbetsha shumë dovòlen nga juve. Këto bera o t'u jap juve, që të roni. 10. O t'lishoni beratë ni dit, djella kur t'dalë, gjer kur t'vejë të përëndojë djella. 11. O t'veni ni gur sinor; dë katra o t'veni nga ni gur. 12. O t'vini prapë dë mua, unë o t'i jap kartë, senet nga mua mbreti, për të ishtë tuoj aju vënt. 13. Nuk o t'i dënak, pa parà o t'e jap juve vëndin.» 14. Tatja më sa mua ashtu: prifti jerdëka me fëmilënë, — me halenë, me këzanë. 15. Pëstaj djutë vëllazëra, tatja më sa mua, markanë këtëj gra. 16. Shklira, greqe, nuk di. 17. An.à kutu greqe nuk paska. 18. Nuk e di ëmërnë priftit. 19. Unë emëratë nuk i di vëllazërave... 20. Pas kësaj vajtkanë turqetë Stamboll, tatja ashtu më sa mua. 21. Aqe më ka sënë, atë di. 22. Gjorgji e thojnë tatenë. 22. Mua, Dine Gjeorgjiev Ollovadov. 24. Unë pensioner seftë sivjet jam. 25. Gjasht' e ni vjeç. 26. Vajta tri vjet skulo gërqishtë.

Tregoi Dine (Kostandin) Gjeorgjiev Ollovadov.

4.

1. Unë kam gjegjur nga time tate, më ka thënë ashtu, që kleqemi ne arnaute nga toni Shqipëria; nga Vithkuq kleka fshati. 2. Tontë vëllazëra, djutë serkanë mish dë vojskaja, andej kur jerdëkan nga Arnautllëku gjer dë Qytet. 3. Pëstaj, kur bëkan stop veqe, xallahitkan djutë vllazëra, thënkane: «Neve nuk o t'veni-si papë. Të vem dë mbreti të xallahimë, t'shom ç'o t'i soj.» 4. Këto vatkan dë mbreti 5. I sënka-hi mbreti: «Nuk o t'veni-si papë.» 6. «Neve nuk o t'veni-si papë, o t'mbetemi kutu dë vënt. Ja ku bendismë ni vënt. Atje të rojmë, ç'o t'thosh?» 7. Mbreti i sënka ashtu: «Jecëni atje, lishoni beratë ni dit, dë katër ana veni nga ni gur: atë o t'e jap juve.» 8. Këto jerdëkanë pëstaja, lishojtkan beratë, dë katër ana vëkan nga ni gur, vatkan-si prapë, pa i sënkan mbretit: «Ne vamë dë ai vënt, atë punë e bëmë.» 9. Pa i sënka-hi mbreti: «Unë mbetsha shumë dovòlen nga juve. Berat o t'i jap bakshish, o t'i bën ni kartë, ni kartë dokument, nuk o t'paguani hiç parà, nuk o t'jepni parà. Nga mua bakshish.» 10. Bëka kju ni kartë, i zënka-hi, i bëka bakshish ato...

11. Pëstaj paskan ni prift vlla, ni vlla paskanë: jerdëka me semësën andej. — me grua-him de, me semesën, me këzanë. 12. Jerdëkan kutu dë këtë vënt, pa bëkan dë këtë vënt Mandricënë. 13. Mua timë tate ashtu më tha, që ashtu e di. 14. Pa pëstaj veqe vatka Turku dë Stamboll. 15. Anë... 16. Ashtu me sa, ashtu di... 17. Unë jam Dine Ollovadit.

Tregoi dhe u regjistrua në manjetofon, Dine Gjeorgjiev Ollovadov.

5.

1. Fshati kutu kle arnautë. 2. Ni mandrë paska: nga mandra u mbetka kutu. 3. Tri hanë klekanë; nga tri u bëkan gjashtë; gjashtë krekan, kurdiskanë mandrënë. 4. Mandrënë si e kurdiskanë, klekan çobanë, — zejnë beratë. 5. Ni bylyk bera paskanë. 6. Atë bylykun bera, ... këta ni nga ni klekan tri vllazëra. 7. Ata tri vllazëra bëhenë zjet hanë. 8. Gjis gjis u shtuokanë, u bëkanë ni qint hanë. 9. Ato ni qintat hanë nisë të merenë, nisë të japnë ni me ni. 10. Këtej lartem klishë, drutë anthi i prekan. 11. Papo Todori e mbajka mënt kur klekan tri çobanë. 12. Kur e bëkan klishën, natën e kurdiskan, mos shohnë që prekan drutë, që t'e bëjnë klishë. 13. U bëka maze fshati, gjer dë katrë qint e gjashzjet hanë. 14. Aqe e mba mënt unë. 15. Gjis arnautë klenë, t'huoj nuk kish, hiç nuk paska. 16. Tontë merinë nga huojtë, — nuk sosnë çupat: çupat klënkak pak, djemtë më shumë klënkak. 17. Pëstaj u trazuan shkllira me arnaut.

Tregoi Mite Fënukov.

6.

1. Fshati është kurdisurë nga tri vëllazëra: nera kleka prift, nera çoban, nera kasap. 2. U mbetkan kutu, e pëlqyekan vëndinë. 3. U kleka ballkan. 4. Bëkan shtëpi tri vëllazëra, u martuokan. 5. Nernë grua e kanë marë nga Gjyshçunar, jatrën nga Kajxhik, jatrën nga Domusderë, dë shkle. 6. Si u martuokan, Perëndia i zënka këzane. U bëka maze fshati. 8. Dë. Turqisë kohë, kur u rahnë me Rusnë, ahere erkan kutu këto tri vllazëra. 9. Klekan dostafçik, zënkak mish dë Turku, dë muharebë. 10. Turku e kish vëndinë, ai kle kutu mbret. 11. Turku e kish, amà glufënë nuk e ngati hiç. 12. Ze skulontë nuk i ngati, ze klishën nuk e ngati. 13. Skula ze klisha klenë gërkisht. 14. Gërkisht këndonim neve. 15. Shklau jerd dë dymbëzjeta, kur u zun me Turkun të rihen, Ballkanit rāhorë. 16. Shklau jerd e muor këtë vënt ze bitisi: u mbetmë dë shklau veçe... 17. Prifti me dji vëllazëra nga Korça klenë. 18. Unë aqe gjigja nga pleqtë. 19. Ka pesë qint vjeç fshati që ishtë kurdisurë.

Tregoi Risto Haxhiev.

7.

1. Demek ne klekemi nga Korça, nga Albania. 2. Klekan çobanë, zënkak bera dë mbretëria, dostafçik, dë askeria zënkak mish. 3. Gjashtë shtatë hanë klenë. 4. Kutu u zënkak fshati. 5. Niska të shtohetë: kaurë qint e peszjetë hanë kish dalë. 6. Ze çdo mot bënin kutu nga zjetë pesëmbëzjetë shtëpi. 7. Shumë përpara venish fshati. 8. Ata të seftëshmit bota që ishnë, klenë Juan, Jorgji, Shtifan. 9. Jatërat ku t'i

mba mënt? 10. Ze prift sonin që kish. 11. Mun' të kaj pesë qint vjeç. 12. Ne nga pleqtë këtë gjegjmë. 13. Pëstaj, lartmen klisëh bëkanë, ka tre qint, katër qint vjeç. 14. Ne kishmë një dado, ai vaska dë Stamboll, pa këruaka të bënish klisëh, — dado Gulamxhiu. 15. Vate mor atë ferman, pa e suoll kutu, pa e bënë klisëhë.

Tregoi Shimion Margarit Gulamxhiev.

8.

1. Kur klenë kutu, tontë dodora ashtu soninë, jertnë turqetë. 2. Pa kur pakanë, pa i thënkkan grave: «Fshihuni!» 3. Paska shërëpane të fshehenin gratë. 4. Papo buratë nuk i ngitshinë. 5. Pa pëstajë vinin dë jatrë vënt, dë Gjushqinarë, pa dëlninë gratë dë punëra... 6. Ishtë një arnaut në Qytet asqer. 7. Të lishohet nga asqerllëku, të bëka kasapllëk. 8. Bitiska asqerllëkunë, zbritka këtej. 9. Kutu gjis pa insan kleka. 10. Ecën, e gjen këtë vënt pa e pëlqen. 11. Vjen kutunë, e sheh vëndinë, bëka ni shtëpi arnauti, vete mer gruvo ka toni vënt, ka Arnauti-si. 12. Pëstaj bën këzane, ritenë, marinë Gjushqinar ni çupë. Ashtu jemi trazuarë, nga ahëre. 13. Pëstaj s'më vjen dër mënt të som jatëra... 14. Kur jer andej ka asqerllëku, mandrë bëka, përandaj Mandricë e sojnë. 15. Nuk më vjen dër mënt përemërë: e sojnë, ma e kam zbjërë... 16. Pa kur shihemi me juve, më vjen gëzim: vëllazëratë më dukeni që jeni... 17. Kur e marka Turku kërshtejkënë, pa i sënka: «Unë o t'mar tynë, pa klisëhë mos e lësh; o të vejsh dë klisëh; këzane o t'i pagëzosh...» 18. E të njohësh ti ç'o të soni!...

Tregoi S. Gjençosë,

9.

1. Tri Ristora janë: neri prift. 2. Prifti me nerin Risto, me gra kanë jerdur kutu. 3. A jatri ka jerdurë pa gruo, pa ka martur gruo nga Sifkladeneç. 4. Pëstaj jatëratë nga tejmi lumë, Tarifshat, — Novoselo, — kanë jerdur kutu. 5. Kutu shkle ishnë, amà u bënë arnautë. 6. Kutu lart ca shtëpi paska: ze ata jernë kutu. 7. Ze ata shkle klenë. 8. Kutu poshtë paska jatër fshat, ndë ëmërë Kliselik: ze ata jerdëkan kutu. 9. Amà ata nuk shkle. 10. Çë klekan ata? 11. Greqe klekan. 12. Ato që vinishninë kutu, o t'bëheshin arnautçe kutu... 13. E kam këndohtur ndë Solun, dë fillade, gërqiisht. 14. Neri e ka shkrohtur; nuk e di më. 15. Dë shtatëmeta senë e kam këndohtur... 16. Mandrica u ka bënë dë Ali pashasë kohë. 17. Më parë nuk e di që ishtë fshat. 18. Nga tri të Ristura u ka zënë.

Tregoi Mite Jovan Dailov.

10.

KOOPERATIVA E MANDRICËS

1. Një qint e shtatëzjetë shtëpi kooperatore janë. 2. Tri brigada janë. 3. Dë ni brigadë jakën ka dyzet hanë, nga tetëzjetë gjer dë ni qint e nizet veta. 4. Çdo brigadë ka ni brigadir. 5. Tri brigada kemi, katër brigadir janë. 6. Unë jam brigadir dë batitë. 7. Ato tri brigada janë dë ara, që qitnë kukuletë, tjtujynnë, rapka, ale punë.

8. Kemi norma. 9. Të sojmë: sot të mih dju kubik baltë, të mar ni trudov den. 10. Ai ditë duhet të marë nizet lefe të dalëtë moti. 12. A n'qittë pes qint dita, nga nizet lefe, o t'marë zjet lefe të ditë të trudov den. 13. Ashtu ishtë bënë plani, të marnë nga nizet të ditë të trudov den. 14. Për gjisë, aqe o t'ishtë dita. 15. Ca hanë bëjnë me shumë punë, ca me pak. 16. Me pak bota janë të hanë, me pak para marnë. 17. Ushtro tashi: ni sallam kooperator, për punën që ishtë të mot, i bëjnë plan të qitë, të sojmë, dy qint peszjetë dita. 18. Mir' ama, ai punon me shumë ze qit me shumë dita, të sojmë tre qint e peszjetë dita, ze mer për ato tre qint e peszjetë dita para. 19. Nga nizet lefe kur t'e bësh hesapnë, shtatë mil pes qint lefe o t'marë. 20. Ka botë që o t'marnë ze nizet, ze nizet e pesë mil lefe të mot.

21. Toni teqezesë e sojnë «Gjorgji Dimitrov» ze ka djumbëzjetë milë djyljyme. 22. Vreshtë kemi nga ni djyljym të hanë për neve-si, ze nga dy dyljyme kemi jatër vënt. 23. E mbjellmë bostan, rapka, kungul, pepere, frenge ze jatër për ngrënë... 24. Toni teqezesë me shumë punon tytyn ze kukule, se nai shumë para nga ato bijenë, se shumë tar shitetë tytyni ze mundafça ndë jatëra mbretëri, ze me ato neve marmë makina... 25. Nuk kemi të fshat makina: gjisë me bati punojmë, me lopa, mushka ze kuol... 26. Këtë senë sadë, Mandrica mbuoll ni mil gjashtë qint dynyme tjtjym, ze gjashzjetë milëra killora kukulle qitme. 27. Killonë tpytpynit e shesme tetëmet lefe; killonë kukules nizet e katër lefe sdrednoci... 28. Kemi ni kamjon ze ni aftomobil Gaz toglë. 29. Ziet veta mer Gazi...

30. Toni teqezesë ishtë bënë të pesteteta senë...

31. Ndë tonë fshat, pestedy janë sadë çlënove na pàrtida. 32. Nuk kemi tashti kandidat partini çlënove. 33. Unë jam sekretar të partia nga pesteteta senë...

34. Tashti gjenden ze ale bota që nuk ishtë mirë, ama ato janë llara bota, llara bota që kishnë shumë gjë, që kishnë shumë para. 35. Atyrmet nuk i vjen-him mirë. 36. Jatrëtë don, jatrëtë ishtë mirë...

37. Punojnë shumë të teqezesë bota, qitnë shumë: gjer të ni mil pes, ni mil tet qint sërëkë. 38. Ni sërëk vjet tet qint grame, ni killo. 39. Me kuvetli vendi kur ishtë, me shumë killora del. 40. A kur ishtë me zaif, me pak del...

41. Zor kur bënishmë kooperativnë nuk pamë: për dy ditë bitisi. 42. Kutu nuk e bënishnë përpara, për çime nuk ishtë udopstà të bëhet kooperativi: nuk kishtë pranë makina, për munt të ni ndihmë të punë. 43. Ze nai seftë sanë që o t'bëjmë kooperative sadë hushërat, a të ballkanetë e të bairëtë me geç. 44. Ale zakon duoll pëstaj të bëhet kooperativ ze të këto vënt, ze u bë kushtu ze Mandrica kooperativ...

43. Mandrica kishtë dy qint peszjetë shtëpi, ma nashti rojnë ni qint e tetëzjetë hanë. 46. Gjës, nëntë qint veta, zhiteli.

Tregoi Gjili Bojaxhiut, mazi brigadir teqezesë Mandrica.

SHËNIME MBI GOJËDHËNËN E MANDRICËS

1. TREGON N. DAKOV

1) *Shqiptar*, kjo fj. ka nisur të përdoret tani vonë në Mandricë, ku në vend të saj thuhet *arnaut*. *Dostafçik*, furnizues me mish i ushtrisë, tregëtar bagëtish. 2) *Dërzhava*, qeveria. *Memlym*, i knaqur. 5)

Danak, taksë. *Pë ze*, për dhe. 6) *Nishtu*, asgjë. 8) *Papazianë*, priftëreshën. *Ndanë*, pranë. 18) *Potpismi*, të nënshkruaj.

3. TREGON D. OLLOVADOV

3) *Bendiskan*, pëlqyekan. 4) *Qutet*. Adrianopoli. *Bëkan veqe stop*, tanimë pushokan. 5) *Velàeti*, vendi i lindjes. Shqipëria. 6) *Ç'do t'i soj, ç'do t'u thotë, ç'do të na thotë*. 9) *Dovolen*, i kënaqur.

4. RITREGON D. OLLOVADOV

1) *Shqipëria*, fj. ka hyrë tani vonë në gjuhën e Mandricës. Atje thonë tq. Arnautllëk ose Arnauti-si (Arnauti ynë) ose dhe Allbania. 2) *Vojskàja*, ushtria. 3) *Ç'o t'i soj, ç'do na thotë*. 11) *Semesën*, gruan.

5. TREGON MITE FËNUKOV

3) *Hanë*, shtëpi. 4) *Zejnë*, mbajnë. 9) *Të merenë*, të bëjnë krushqi. 10) *Anthi*, kastile.

6. TREGON R. HAXHIEV

3) *Ballkan*, mal, pyll. 9) *Muharebë*, luftë. 10) *Glufënë*, gjuhën. 12) *Skulontë*, shkollat. 15) *Ràhorë*, luftë.

7. TREGON SH. GULAMXHIEV

8) *Të seftëshmit* bota, njerzit e parë. 11) *Mundë kaj*, mund të ketë. 14) *Dado*, gjysh, plak.

8. TREGON S. GJENÇOSË

1) *Tontë dadora*, pleqtë, gjyshët tanë. 18) *E si ta marrësh vesh ti se ç'po të thom unë*.

9. TREGON M. DAILOV

4) *Tarifshat*, Fshati i ri, sl Novoselo. 12) *Vinishninë*, vinin. 13) *Solun*, Selanik. 15) *Shtatëmeta senë*, viti shtatëmbëdhjetë (1917).

10 KOOPERATIVA E MANDRICËS. TREGON GJ. BOJAXHIUT

3) *Jakën*, gati, rreth. 5) *Batitë*, bagëtitë. 7) *Qitnë*, nxjerrin, kultivojnë. *Kukuletë*, tjtjyynnë, rapka, ale punë, mëshikat e mëndafshit, duhanin, misrin, të tillë punë, 9) *Të sojmë*, të thomi, për shembull. *Kubik*, metër kub. *Ni trudov den*, një ditë punë. 10) *Lefe*, leva (monedha bullgare). 21) *Teqezesë*, kooperativë. 22) *Për neve-si*, për vete. 23) *Bostan*, karpuz. *Peperë*, frenge, piperka, domate. 24) *Nai shum*, më shumë. *Tar*, shtrenjt (nga: të ar, flori). 26) *Sadë*, vetëm. 27) *Sdrednoci*, mezatarisht. 31) *Çlënove da pàrtida*, anëtarë partie. 34) *Llara*, të rrallë. *Gji gjë*, pasuri. 38) *Sërëkë*, vargje (duhani), çërrikë. 39) *Me kuvetli*, sa më i shëndoshë. 40) *Me zaif*, më i dobët. 42) *Këtu nuk e bënë përpara* (kooperativën), sepse (*për çime*) nuk ishte e volitëshme (*udopstà*). *Për munt të ni ndihne*, për të na ndihur. 43) *Hushërat*, fushat. *Dë bairët me geç*, në pyjet më tej, më vonë. 44) *Pastaj doli ligj i tillë (ale zakon)* që të bëhet kooperativë dhe në

këto vende... 46) *Zhiteli*, banorë. *Mazi brigadir*, brigadieri i madh, i parë.

PERSONAT QË NA THANË KËNGËT, PËRRALLAT ETJ

DILI ÇANKOV, bujk, pa shkollë, 67 vjeç.

DINE GJEORGJIEV OLLOVADOV: «Unë pencioner sefte sivjet jam. Gjashteni vjeç. Vajta tri vjet skulo, gërqishtë.» Fshatarët më thanë se Dineja (Konstandini) është nga ata që e mbajnë mend më mirë gojëdhënën e Mandricës. Për fat të keq, Dineja nuk e ka dhe aq të qartë shqyptimin. Historikun e fshatit ia morëm për së dyti, duke ia regjistruar në manjetofon.

ELENA GJEORGJIEV MAJKOVA, bujkeshë, ka bërë 7 klasë në shkollën bullgare, 27 vjeç.

GJILI BOJAXHIUT (ANGJELL BOJAXHIEV), bujk, ka bërë 7 klasë në shkollën bullgare, «sekretar dë partia nga pesteteta senë» «mazi brigadir teqezesë Mandrica», 33 vjeç.

JANA ATANAS MULLUSHEVA, bujkeshë, pa shkollë, 57 vjeç. Një nga pjesët nga «Maraflos masalla» ia regjistruam për së dyti në manjetofon, pjesën e fundit të përrallës. Di përralla dhe këngë mjaft. Në fillim nguroi pak, pastaj tregoi me qejf.

JANA TYTYNXHIEVA, bujkeshë, ka bërë 6 klasë në shkollën bullgare, 27 vjeç.

KATINA PETROVA, bujkeshë, ka bërë 6 vjet në shkollën bullgare, 35 vjeç. Këngën «Tudorqe, bukor Tudorqe» na e tha dhe këndoi pjesërisht bashkë me Elena Majkovën. Duhet të dijë dhe shumë të tjera. Kur e tha atë këngë, ishte aty edhe një grua e re prej origjine bullgare, e martuar me një shqiptar nga Mandrica; kuptonte shqip dhe fliste pak. Kjo tregoi se këngën e thonë edhe bullgarisht. Ngandonjëherë, Katina harronte dhe ndonjë varg, e thoshte bullgarisht, pastaj e thoshte shqip, duke qeshur. Dukej në atë çast sikur përkthente nga njëra gjuhë në tjetrën.

MARIA LLAMBRUA POPOVA, bujkeshë, pa shkollë. Thotë: «Jam gjazhjet e pes vjeçme... Ni kohë nuk venish gjis dë skulo; mbanim këzantë... Këto fjalë mos i vini dë radjo, pa të qeshen mua tër jeta!» Është një plakë shumë e gjallë. Sipas fshatarëve, është ajo që di më shumë këngë në Mandricë. I thotë dhe i këndon pa e lutur shumë, me qejf e me dëshirë, gjithëmonë duke qeshur e duke bërë shaka. Prej saj morëm këngët më të shumta. Ishte mbrëmje, u err dhe nuk mundëm t'i marrim më shumë, tek punonte, shkonte duhan në fije. Premtoi të na thotë plot të tjera të nesërmen në fushë, tek do të

mblihdte arra me shoqet: vajtëm e kërkuam, po nuk e gjetëm; dhe kështu mblodhëm këngë të tjera nga fshatare të tjera. Ka shqyptim shumë të pastër.

MITE JOVAN DAILOV, bujk, ka bërë 6 vjet shkollë greke, 68 vjeç. Kur na tregoi historinë e fshatit Mandricë, sipas një libri greqisht që ai vetë kishte lexuar në Solun (Selanik), më 1917, fshatarët e tjerë protestuan, duke thënë se nuk ishte kështu historia e Mandricës, me asnjë farë mënyre. Emrin e librit dhe të auktorit nuk e mbante mend. Është një ndër ata që përcakton afërisht kohën kur u themelua Mandrica: në kohë të Ali pashës (Tepelenës). Për këtë kohë më folën dhe disa të tjerë në Mandricë, po të gjithë pandehin se Ali pasha ka jetuar rreth pesëqind vjet më parë.

MAGDALENA MOSKOVA, bujkeshë, ka bërë 5 klasë në shkollën bullgare, — «dë shkllaut skulo.» Thotë: «Di cingë shkron.» 50 vjeç.

MITE FËNUKOV, bujk, ka bërë tre vjet në shkollën greke, 86 vjeç. Më thanë se është plaku më i vjetër i Mandricës. Mezi mbahet me shëndet. Ka harruar shumë dhe mezi na e tregon gojëdhënën e fshatit. S'e ka shqyptimin të qartë, për shkak të dhëmbëve që pjesërisht i mungojnë. Gjuhën e flet me pak nën ndikimin fonetik të bullgarishtes, se sa të tjerët që dëgjuam. Zakonisht përdor *th* e *dh*.

RISTO HAXHIEV, bujk, pa shkollë, 62 vjeç.

«**STANO GJENÇOSË, RISTOSË GRUVË**» (kështu na e tha emrin), bujkeshë, 70 e sa vjeç (s'e di mirë ajo vetë, as të tjerët). Plakë shumë e gjallë, shumë e thjeshtë, gati si fëmijë në sjelljet e saj, shumë e dashur dhe e ndieshme. Na tha: «Kur shihemi me juve, më vjen gëzim; vëllazëratë më dukeni që jeni!» Bënte gëzim të madh, vërtet, që fliste me ne.

SHIMION MARGARIT GULAMXHIEV, pa shkollë, 82 vjeç.

SULLTANA TABAKÇIEVA, bujkeshë, ka bërë 3 klasë në shkollën bullgare, 54 vjeç. Di këngë shumë, po i vajtëm vonë në shtëpi dhe ngutej të mbaronte punën (shkonte duhan në fije) dhe të vinte të shihte të dhëndërin që e kishte sëmurë aty në fshat. Thosh: «Më shtrëngonit zëmra! Kam sëmurë bilësë bur, zëndërë... Bila ka ni djalë ze ni çupkë, Vanço ze Dijankë. Bukorë çupkëzë: pesë vjeç, ma lartë bojë... Shum mbeta e fkaristurë që erthtë, që ju pasha, bota nga tona besë që jeni... O t'më kshahasni?... Ze të kremnera, ze të djela, ze të punëshme dit, gjis

punojmë. (Atë ditë, qe e djelë, prandaj thotë kështu Sulltana). Shumë faturë bullkave.»

TRISA GJEORGJIEVA GJENÇOVA, bujkeshë, ka bërë 6 klasë në shkollën bullgare, 30 vjeç.

URANIA MAJKOVA, bujkeshë, ka bërë 3 vjet shkollë greke, 62 vjeç. Ka banuar 5 vjet në Shqipëri, prandaj nuk i duhet besuar shumë gjuhës së saj, me gjithë se nuk duket të ketë ndryshuar të folurën, si i shoqi dhe djali i saj, të cilët e përzbejnë të folmen e tyre me atë që kanë mësuar në Shqipëri.

NASHO VASIL DAKOV, thotë: «Tetzet e dju vjeçme jam. Dë gërqiisht, aqe di, potpismi. Shklerisht di t'e potpis timëm ëmërë. Kutu jam pjellë, dë Mandricë.» Bujk.

MAJDALINO TOSKA, pa shkollë, 65 vjeç. Ninullën që na tha, ia këndoi në sy tonë të nipit të vogël motmotak.